



Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror

Nr. 3 / Dhjetor, 2024

Oda e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve tjerë Shëndetësor



Një dekadë së bashku



**Largimi i infermierëve, brengë që duhet
ta trajtojnë institucionet shtetërore**
fq. 6



**Stafi profesional i OIK-ut, i përkushtuar në
profesionalizëm dhe punë të palodheshme**
fq. 7



Oda e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

Oda e Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor - OIK

www.oik-ks.org
revistaoik@gmail.com
Rr. "Holger Pedersen",
Prishtinë 10000, Kosovë

Kryeredaktor
Muharrem Arifi

Zv. Kryeredaktorë
Lirije Beqiri
Donika Shahini Lami

Anëtarë të redaksisë
Xhavit Ramadani
Rexhep Jakaj
Feim Hasani
Vlora Ejupi

Lektor
Xhavit Ramadani

**Distribuími online dhe
radhitje kompjuterike**
Besian Hajrizi

Shtypi:
Tirazhi: 3000 copë

Revista jepet falas!

Prishtinë, Dhjetor 2024

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare mbetet synimi ynë

Editorial



Nexhmije Gori

Reflektimi për arritjet, sfidat dhe mundësitë për të ardhmen është mëse i nevojshëm në këtë përvjetor të dhjetë të Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

Infermierët, janë themeli i sistemit shëndetësor, "ushtarët" e devotshëm të betejave për shëndet, posaçërisht në kohë lufte dhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ku ata ishin në vijën e parë të betejës për shpëtimin e jetëve.

Në këto dhjetë vjet të ngritjes dhe funksionimit të OIK, profesioni i infermierisë ka përjetuar zhvillime të rëndësishme. Rritja e numrit të infermierëve të trajnuar dhe të diplomuar, përmirësimi i kushteve të punës dhe mbështetja nga institucione shtetërore dhe ato ndërkombëtare.

Megjithatë, profesioni i infermierisë vazhdon të ndeshet me disa sfida të mëdha. Paga e ulët dhe kushtet e punës shpesh janë të papërshtatshme, duke çuar në një rrezik të lartë për migrim të infermierëve jashtë vendit, ku ata mund të gjejnë mundësi më të mira për karrierën e tyre. Stafi infermieror shpesh është i pamjaftueshëm, duke krijuar një ngarkesë të madhe pune dhe stres gjatë kryerjes së punëve.

Një tjetër sfidë është përmirësimi i kushteve të

infrastrukturës në institucione shëndetësore, që ende kërkojnë investime të mëdha për të siguruar që infermierët të kenë mjetet e duhura për të kryer detyrat e tyre me efikasitet dhe siguri.

Për më tepër, është e nevojshme që infermierët të përfshihen më shumë në vendimmarrje dhe në politikat shëndetësore, për t'u siguruar që shërbimi që ofrohet është i nivelit të duhur dhe i përkushtuar ndaj pacientit.

Ky dhjetëvjeçar gjithashtu ofron mundësi për reflektim dhe përmirësim. Dëshira për të ofruar kujdes shëndetësor të nivelit të lartë dhe për të forcuar sistemin shëndetësor është një motiv i fortë për të investuar më shumë në arsimimin dhe mbështetje profesionale për infermierët. Po ashtu, është e domosdoshme të krijohet një sistem motivimi që do të tërheqë dhe do të mbajë infermierët, duke përfshirë pagat më të larta, përmirësimin e kushteve të punës dhe mundësi zhvillimi profesional. Në këtë dhjetëvjeçar, është thelbësore që shoqëria të njihet më shumë me rëndësinë e infermierëve dhe të vlerësojë kontributin e tyre në mirëqenien e popullatës.

Të gjithë duhet të angazhohemi për të forcuar këtë profesion dhe për të siguruar që infermierët të kenë mbështetje dhe mundësi për të ecur përpara me dinjitet dhe krenari. Fokusi jonë nuk ka qenë vetëm në edukim të vazhdueshëm, OIK është bashkërenduar meodat tjera në marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për ndërtimin e objektit të odave të profesionistëve shëndetësorë. Me këtë rast, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka ndarë tashmë pronën dhe jemi në fazën finale për fillimin e ndërtimit të objektit. Kemi marrë pjesë në shumë aktivitete, konferenca, kongrese me karakter vendor dhe ndërkombëtar. Ajo që duhet potencuar këtu është

se gjitha organizimet që kemi bërë, kanë lënë një "shije të mirë" për gjithë pjesëmarrësit, posaçërisht ata nga Evropa dhe vendet tjera mike.

Me këto ndryshime synohet të arrihet avansimi i profesionistëve shëndetësorë duke rritur transparencën, llogaridhënien si dhe cilësinë në kujdesin shëndetësor.

Jam shumë e lumtur që për herë të parë kemi arritur të krijojmë një komision për veprimtari botuese i cili në kuadër të OIK tashmë ka filluar të nxjerrë revistën Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror.

Një e arritur tjetër është hapja e zyrës së psikologëve, logopedëve dhe orgoterapistëve e cila zyrë ju ka dhënë një autonomi të plotë këtyre profesionistëve në kuadër të OIK.

Po ashtu, për herë të parë, OIK ka decentralizuar shërbimet e saja, duke qenë afër anëtarësisë së saj në gjitha regjionet, e ku kemi zgjedhur 6 koordinatore regjionale që janë gjithmonë të gatshëm për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të anëtarëve të OIK.

OIK është bërë pjesë e Krenimit të 125 vjetorit të themelimit të ISN me ç'rast kemi nënshkruar edhe Deklaratën e Bukureshtit, si një hap shumë i rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e profesionistëve shëndetësorë kosovarë.

Jemi duke punuar me ekipën tonë jashtëzakonisht shumë në promovimin ndërkombëtar të OIK, duke kryer obligimet dhe detyrat që dalin nga OBSH dhe organizatat infermierore ndërkombëtare si ICN dhe EFN. Kjo, pasi synimi ynë mbetet anëtarësimi në këto organizata.

Bashkë ia dalim gjithmonë!



Legjislatura e dyte e OIK-ut (2019 - 2023) Pjesa 1

Lirije Beqiri

Prishtinë, Dhjetor 2024

Katër vite pas themelimit të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës sipas Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr-04/L-150, si pjesë e pakos legjislative reformuese brenda Ministrisë së Shëndetësisë, përfundon mandati i parë katër vjeçar i kryetarit Z. Naser Rustemi dhe të gjitha organeve të OIK-ut. Duke

respektuar legjislacionin formohen organet si: Këshilli Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Sekretaria e Këshillit Qendror Zgjedhor (SKQZ) të cilët sigurojnë që do të ketë një proces zgjedhor demokratik dhe transparent, duke siguruar gjithëpërfshirje profesionale, institucionale dhe territoriale.

Këshilli Qendror Zgjedhor (KQZ) ishte në këtë përberje: Prof. Hysni Bajrami, Znj. Adelina Shehu, Znj. Afërdita Berisha, Znj. Ferdane Miftari si dhe Znj. Elmaze Rustemi.

Kuvendi i Legjislaturës së dytë 2019-2023, përbehej nga 151 delegatë të zgjedhur në njësitë zgjedhore më 15 janar 2019, nga të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private nga e mbarë Kosova.

Kuvendi i parë konstituiv i Legjislaturës së II-të, të OIK (2019-2023), u mbajt më 22 janar 2019, për zgjedhje të kryetarit. Kandidatë në garë ishin: z. Mentor Hasani dhe z. Naser Rustemaj.

Në këtë Kuvend me 132 vota apo 91.04% të votave të vlefshme kryetar i OIK edhe për një mandat u zgjodh Z. Naser Rustemaj

Në mbledhjen e dytë të Kuvendit, në legjistraturën e dytë të OIK, të mbajtur më 22.02.2019 kryetari Rustemaj propozoi zgjedhjen e nënkryetarëve me ç'rast nënkryetarë u zgjodhën z. Xhemajl Dugolli dhe Lirije Beqiri. 0

Në vazhden e angazhimeve, 11 Maj 2019 - Oda e infermierëve synon të standardizojë kompetencat me BE-në



Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestrara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



Oda e Infermierëve të Kosovës do të mbështetet nga ekspertë evropian në fushën e edukimit si dhe standardizimit të kompetencave dhe thirrjeve infermierore në pajtim me direktivat e BE-së. Kryetari i Odës së Infermierëve të Kosovës Naser Rrustemaj ka zhvilluar një takim me Ministrin e Shëndetësisë së Sllovenisë, Alesh Shabeder, në prezencë edhe të homologes së tij, kryetares së Odës së Infermierëve të Sllovenisë, Monika Azhman.

U mbajtë Konferenca e parë Vendore 04-05.05.2019 - "NDEROJME TË KALUAREN - NDËRTOJME TË ARDHMEN - Tema: Roli i Infermierisë gjatë luftës në Kosovë dhe të arriturat gjatë 20 viteve. Pjesëmarrës aktiv me prezantime 14, Pjesëmarrës Pasiv: 384.

23.05.2019 Oda e Infermierëve në mbështetje të viktimave të dhunës: Oda e infermierëve të Kosovës, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën e grave "Medica Gjakova" e që ka për qëllim të mbështetjes dhe integritit në të gjitha sferat jetësore të grave të mbijetuara nga dhuna.

Një marrëveshje e bashkëpunimit e lidhur mes kryetarit të Odës

së Infermierëve të Kosovës (OIK) Naser Rrustemaj dhe Drejtoreshës Ekzekutive të Shoqatës së Grave "Medica Gjakova" Mirlinda Sada ka për qëllim përmirësimin e gjendjes mendore dhe fizike të grave të mbijetuara nga dhuna si dhe ndikimin mbi politikat sociale në mbështetjen e mirëqenies së grave dhe integrimin e tyre.

Kryetari i Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK), Naser Rrustemaj ka thënë se në përgjithësi marrëveshja synon mbështetjen e realizimit të një projekti që synon forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike për gra dhe vajza

të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Projekti do të implementohet në dy komuna, në atë të Gjakovës dhe të Prizrenit.

Ndërkohë, në marrëveshje specifikohet se në këtë projekt do të përfshihen rreth pesëmbëdhjetë qendra të Mjekësisë Familjare në Gjakovë dhe Prizren si dhe spitalet e përgjithshme të Gjakovës dhe Prizrenit.

Kështu, OIK ka marrë obligim që të përkrahë në implemetimin e projektit "Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj traumave për gra dhe vajza





të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”.

Sipas marrëveshjes së nënshkruar nga dy palët, OIK do të bëjë përzgjedhjen e infermierëve për përfshirje në këtë projekt nga radhët e Kuvendit të Odës së Infermierëve të Kosovës.

Platforma digjitale

Në vazhden e angazhimeve të kryetarit dhe stafit të OIK, Oda e infermierëve të Kosovës, ka vënë në dispozicion Platformën Digjitale, përmes së cilës çdo infermier mund të antarësohet në OIK, mund të aplikojë online për licencim e rilicencim, si dhe të kryejnë shërbime shumë të rëndësishme administrative.

Oda e Infermierëve të Kosovës nderohet me “Mirënjohjen e Qarkut Shkodër”

Duke vlerësuar nivelin e marrëdhënieve të krijuara midis profesionistëve shëndetësorë të Qarkut të Shkodrës me profesionistët shëndetësorë të Kosovës, kryetarja e Qarkut të Shkodrës Greta Bardeli i ka ndarë mirënjohjen Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

Në kuadër të aktiviteteve të OIK-ut në këtë legjislaturë është mbajtur Kongresi i parë Ndërkombëtar me moton “Roli, rëndësia dhe sfidat e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë përgjatë periudhës

së pandemisë Covid-19” mbajtur me datë 5 dhe 6 maj 2021, në bashkëpunim me Institucionet dhe Organizatat nga Shqipëria, Sllovenia, Italia, Turqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia si dhe me universitetet vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.

Kongresi është zhvilluar përmes platformës Online Zoom dhe me prezencë fizike me një numër të kufizuar të pjesëmarrësve me një pjesëmarrje prej 1246 pjesëmarrës, janë prezantuar 82 punime ku nga ato 52 punime ishin ndërkombëtare. Kongresi është mbështetur nga organizata Eastern Balkans Fund (ËBF).





Konsolidohet Këshilli Drejtues i Odës së Infermierëve

Këshilli Drejtues i Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës është plotësuar edhe me tre anëtarë të rinjë, të deleguar nga Ministria e Shëndetësisë.

Fetije Huruglica, Shyqiri Hasani dhe Luljeta Kryeziu u zgjodhën anëtarë të rinjë të Këshillit Drejtues të Odës së Infermierëve të Kosovës, të cilët janë deleguar nga Ministria e Shëndetësisë.

Po ashtu, në këtë takim të Këshillit Drejtues u miratua edhe themelimi i Këshillit Nacional të Odës së Infermierëve të Kosovës. Ky këshill do të jetë organ këshilldhënës dhe që do të hartoj politikat e OIK-ut si dhe do të merret me problemet e infermierëve dhe punonjësve tjerë shëndetësorë”, ka thënë kryetari Rrustemaj



Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) Regjional

OIK ka zhvilluar module të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në ngritjen e kapaciteteve për orfruesit e kujdesit shëndetësorë gjatë gjithë vitit për të gjithë anëtarët me temat: Roli i Odës dhe masat që ndërmerr OIK në rast të shkeljeve profesionale, Të drejtat themelore kushtetuese të njeriut dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në sistemin shëndetësor, Cilësia në kujdesin shëndetësor, Identifikimi i qasjeve diskriminuese në vendin e punës, Karta bio-etike e pacientëve të spitalizuar dhe të drejtat e tyre dhe Nevojat për dialog të rregullt mes komunitetit vendimmarrës”.

Ky edukim është zhvilluar përmes platformës online ZOOM dhe me prezencë fizike, ku janë përfshirë 3580 pjesëmarrës, mbështetur nga Community Development Fund (CDF).



Oda e Infermierëve definton kompetencat

Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), në një punëtori dy ditore të organizuar me komisionet dhe organet e saja, theks të veçantë i ka kushtuar definimit dhe qartësimin të kompetencave të secilit komision si dhe organeve të OIK-ut. Në një punëtori të organizuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës për gjitha komisionet dhe organet e OIK-ut, u raportua për punët e secilit komision gjatë vitit 2019 si dhe u bënë planifikimet e punës për vitin 2020. Po ashtu, OIK në këtë punëtori me organet dhe komisionet e saja theks të veçantë i ka kushtuar definimit dhe qartësimin të kompetencave të tyre. Kryetari i Odës së Infermierëve të Kosovës Naser Rrustemaj, tha se secili komision i Odës së Infermierëve tashmë ka dërguar raportin vjetor të punës dhe angazhimeve.





të Shoqatave të Infermierëve si dhe z. Paul de Reave, sekretar i përgjithshëm i Federatës së Infermierëve të Evropës (EFN). Nikoqir i këtij takimi ka qenë Asociacioni slloven i infermierisë i udhëhequr nga zonja Monika Ažman

kut. Ky obeliskt i vendosur në hyrje të QKUK i dedikohet kontributit të çmuar që infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë kanë dhënë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

OIK drejt anëtarësimit në Federatën e Infermierëve të Evropës

Në takimin e 115-të, të Federatës së Infermierëve të Evropës (EFN) që është mbajtur në Bled të Sllovenisë, OIK ka marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit derisa janë bërë hapa të rëndësishëm për anëtarësimin e OIK në EFN.

Një delegacion i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë i udhëhequr nga kryetari Naser Rustemaj, ka marrë pjesë në takimin e 115-të, të Federatës së Infermierëve të Evropës (EFN) që është mbajtur në Bled të Sllovenisë. Në këtë takim, kryetari Rustemaj dhe delegacioni i OIK, kanë takuar znj. Elizabeth Adams, Presidente e Federatës Evropiane



Kontributi në ngritjen e Obelisikut kushtuar punonjësve shëndetësorë që humbën jetën gjatë pandemisë

OIK në bashkëpunim me të gjitha Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (OPSH), Ministrinë e Shëndetësisë dhe Komunën e Prishtinës si shenjë mirënjohje për kontributin e profesionistëve shëndetësorë gjatë pandemisë COVID-19, ka participuar shumë dominante për ngritjen e Obelis-



Ligji për infermierinë

OIK bazuar në nevojat dhe prioritetet e saja ka hartuar Draftin e Ligjit për Infermierë, Mami dhe Profesionistë tjerë Shëndetësorë dhe i njejtë është proceduar në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim të mëtejshëm. Ligji në fjalë ofron zgjedhje për shumë çështje dhe probleme të akumuluara me vite dhe cakton standarte profesionale të ushtrimit të profesionit sipas profileve.



Intervistë: Leonora Bakija, zv.Kryetare e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionalistëve tjetër Shëndetësorë

Largimi i infermierëve, brengë që duhet ta trajtojnë institucionet shtetërore

Arsyet e largimit të infermierëve jashtë vendit, sipas zv. Kryetares së OIK, znj. Leonora Bakija, kryesisht lidhen me anën materiale. Andaj, ajo thotë se institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës duhet që me prioritet dhe sa më shpejt të marrin masa për përmirësimin e statutit material të infermierëve

Feim Hasani

Një kryeinfermiere e përkushtuar dhe shembull që reflekton në vazhdimësi humanizëm, guxim dhe kurajë për komunitetin, është një prej zërave të rëndësishëm të Odës së Infermierëve, Mamive dhe profesionalistëve tjerë shëndetësorë. Leonora Bakija tash e gati dy vite është nënkryetare e OIK. Revista Shëndeti dhe Kujdesi Infermierorë, duke marrë shkas aktivitetin e saj dhe angazhimin e pasqorë në shërbim të komunitetit infermieror, ka realizuar një intervistë me znj. Bakija. Ajo flet me përkushtim për shërbimet e profilizuara shëndetësore, Edukimin e Vazhdueshëm Profesional si dhe hapjen e shërbimeve të reja, siç është Zyra e Psikologëve Klinikë, e funksionalizuar gjatë këtij viti në OIK. "Jemi të mobilizuar që me sukses t'i kryejmë të gjitha objektivat me numrin ekzistues të të punësuarve në OIK. Për këtë, jemi shumë mirënjohës stafit profesional që me përkushtimin dhe angazhimin e tyre, jemi në nivel të detyrave", thotë nënkryetarja Bakija, në intervistën për Revistën Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror.

Revista Shëndeti dhe Kujdesi

Infermieror: Largimi i infermierëve nga Kosova, sidomos atyre që kanë një përvojë në sistemin shëndetësorë sigurisht që është një shqetësim për komunitetin dhe jo vetëm. Si e komentoni Ju këtë trend të largimeve dhe a ka arsye të forta që po ndodhë?

Znj. Bakija: OIK çdo ditë ballafaqohet me kërkesa të anëtarëve të saj për lëshimin e dokumenteve relevante (Vërtetimit për shkelje Etike), dokumente këto që

shërbejnë për punësim jashtë vendit. Kjo dukuri është mjaft brengosëse, dhe ne si organizatë profesionale për mbrojtjen e interesave të Infermierëve, Mamive dhe Profesionalistëve tjerë Shëndetësorë këtë çështje e kemi ngritur tek institucionet relevante. Kërkesat tona kanë qenë të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve materiale - pagave dhe shtesave tjera, në mënyrë që infermierët dhe profesionalistët tjerë të mos jenë të detyruar të kërkojnë punësim jashtë vendit për shkaqe ekonomike. Arsytet e largimit të infermierëve jashtë vendit mbi të gjitha janë ato që lidhen me anën materiale dhe institucionet e Republikës së Kosovës duhet që me prioritet dhe sa më shpejt të marrin masa për përmirësimin e statutit material të tyre. Përndryshe, në një të ardhme të afërt sistemi shëndetësor në Kosovë do të ballafaqohet me mungesën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionalistëve tjerë shëndetësorë.

Revista Shëndeti dhe Kujdesi

Infermieror: Si e vlerësoni mënyrën e pagesave të stafit infermieror, dallimin mes atyre që kanë shkollim të mesëm dhe përvojë afatgjatë me ata që janë të rinj por që kanë mbaruar shkollim të lartë?

Znj. Bakija: Çështja e barazvlerësimit të përvojës së punës me titujt formal Bachelor të Infermierisë ende nuk është shtruar si prioritet që kërkon zgjidhje. Kjo çështje, fiton aktualitetin e saj në kohën kur duhet unifikuar thirrjet infermiore në rrethana dhe në kohën e duhur do të dalë me program dhe iniciativë konkrete tek institucionet relevante. Gjithashtu



kemi përgatitur dhe përshtatur aktet normative për zgjidhjen kësaj çështje që askush të mos ndjehet i nënvlerësuar për punën që bën.

Revista Shëndeti dhe Kujdesi


Infermieror: Sa janë të domosdoshme specializimet në infermieri, për të përmirësuar shërbimin profesional. A ka ndër marrë OIK hapa konkret për fillimin e specializimeve në infermieri?

Znj. Bakija: Siç është e ditur në Kosovë ende nuk ka specializime në infermieri dhe profile të ngjashme në kuadër të OIK. Ne konsiderojmë se duhet filluar me specializime në infermieri për profile adekuate. Brenda strukturës së OIK-ut është formuar komisioni për specializime, të cilit i është dhënë detyrë që të dalë me program të veçantë për drejtimet më adekuate dhe urgjente që kanë nevojë për profilizim-specializim. Në kontaktet tona me Ministrinë e Shëndetësisë, disa herë kemi ngritur këtë çështje. Deri në fund të këtij viti, në bazë të rekomandimit të komisionit për specializim, do të riaktivizojmë dhe do të inicojmë përsëri çështjen e specializimeve në infermieri. Siç dihet, në bazë të ligjit për Odat e Profesionalistëve Shëndetësorë, shkollimi specialistik, duke përfshirë profilet dhe programet e specializimit, është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Roli i Odave konsiston vetëm në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së këtij procesi. Megjithatë ne si Odë duke pasur përgjegjësinë për mbrojtjen e interesave të anëtarëve tanë, këtë çështje do ta ngrisim në vazhdimësi si çështje me prioritet.

Stafi profesional i OIK-ut, i përkushtuar në profesionalizëm dhe punë të palodheshme

Më shumë se shtatëdhjetë përqind të profesionistëve shëndetësor, të profileve të ndryshme, marrin shërbime nga stafi profesional i Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor. Me përkushtim, profesionalizëm dhe dashuri për punën janë afër komunitetit çdo ditë

Donika Shahini Lami
Xhavit Ramadani



Dafina Bahtiri Rexhepi
- ka një dekadë punë në OIK, përgjegjëse në Zyrën e antarësimit. Puna me palë dhe përkrahja profesionale karshi komunitetit e motivon dhe inspiron pa

fund. "Fakti që jam vet infermiere, më motivon edhe më shumë që të jem afër kolegëve të mi dhe bashkë të jemi shembull i profesionalizmit. Viti 2016, më gjen mua si punëtore e parë të OIK-ut me vullnet dhe inspirim të jashtëzakonshëm".

Dafina, është gruaja që ia del me sukses secilës sfidë. Ajo është kontakti i parë i secilit që mund të ketë vështirësi të natyrave administrative në procesin e antarësimit dhe jo vetëm.

Ajo kujton kohën kur kishte filluar punën, në një institucion të ri, që sapo ishte themeluar dhe para vetes kishte shumë palë, shumë punë, shumë dosje... "Duhej ta ndërtonim kalanë nga e para. Ishte fluksi i madh i punës, duke qenë se vetëm në vitin 2017, i kemi pasur rreth 7 mijë aplikime për anëtarë të rinjë...". Fillimi i lëshimit të licencave është bërë në janar të vitit 2018, hiq më pak se tre mijë licenca. Pastaj në shkurt-mars faza e dytë rreth 4 mijë licenca. Janë shifra që në vehte kanë persona juridik, profesionistë që ishin në detyrat e punës dhe u përgjigjeshin me kohë vendimeve ligjore - vazhdon rrëfimin e saj Dafina.

Sfidat ishin të mëdha, sidomos në adaptim dhe punë të përditshme. Dafina tregon qartë për përkushtimin dhe vullnetin e stafit që gjithmonë japin përgjigje me pozitivitet "Në ato vite, komunikimi ndonjëherë përballej me vështirësi për shkak të mungesës së një platforme të avancuar teknologjike. Radhët e gjata dhe pritjet shpesh krijonin sfida për anëtarët. Por

përkushtimi i stafit për të gjetur zgjidhje efikase ishte i dukshëm. Kjo periudhë ishte një pikë kyçe që theksoi nevojën për të modernizuar mënyrat e ofrimit të shërbimeve" - thotë Dafina Bahtiri Rexhepi, e punësuar e parë e OIK-ut, siç shpesh cilësohet nga të gjithë, njëshi i OIK-ut.

Doresa Gashi - punën në OIK e ka filluar që nga viti 2017. Ajo sot është Udhëheqse e Zyrës së Antarësimit, Licencimit dhe Rilicencimit. Doresa është një prej shtyllave kryesore që mbështet funksionimin e përditshëm të institucionit dhe sigurimin e respektimit të rregulloreve ligjore në të gjitha proceset. Puna me palë (anëtarët e Odës) duke ofruar udhëzime dhe këshilla juridike, veçanërisht në raste kur hasen situata komplekse apo kërkesa të pazakonta në verifikimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim, duke siguruar që dokumentacioni të jetë i plotë dhe në përputhje me ligjin është ana e fortë e Doresës.

"Puna me palë është sfidë, por edhe motiv i çdo ditëshëm për t'iu gjendur në shërbim profesionistëve shëndetësor. Të flasësh sot, në viti 2024 është krejtisht momentum tjetër. Në tetor të vitit 2017, me vendim bëhet obligativ antarësimi në OIK, duke filluar regjistrimin e secilit profesionist të punësuar, / licencuar. Vitet e para të punës time në OIK konsistojnë nga themelimi i Odës deri në marrjen e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë për rilicencim në vitin 2017, ku edhe fillon procesi i valorizimit të lëndëve, fillimisht në mënyrë të organizuar institucionale, si fazë e parë ku Ministria e Shëndetësisë me vendim të gjitha licencat e skaduara deri në fund të vitit 2017, iu jep validitet për të ushtruar profesionin".

Duke pasur parasysh që jo të gjithë respektonin vendimin për rilicencim, gjithashtu edhe faktin se shumë

profesionistë nuk posedonin pikë akredituese, OIK në prill të vitit 2018, organizoi trajnim për të gjithë anëtarët në mënyrë që t'iu mundësohej lehtësimi në proces. Edukimi i vazhdueshëm kishte përfshirje regionale.



Filloreta Basha - është pjesë e OIK-ut nga viti 2018, ajo potencon se: "Procesi i rilicencimit u zhvillua në tri faza. Në fazën e parë u bë valorizimi i pikëve kredituese për anëtarët

që kishin çertifikata të trajnimeve. Në fazën e dytë u mbajtën trajnime intenzive për të gjitha profilet dhe faza e tretë përmes provimit profesional për rilicencim të organizuar nga OIK.

Është interesant të kujtojmë se gjatë asaj kohe pritjet ishin të gjata sepse ishim vetëm tre zyrtarë për të pranuar palët, edhe pse dëshira dhe vullneti nuk mungonte për t'iu përgjigjur në mënyrën më meritore, por fizikisht ishte e pamundur dhe shumë sfiduese. Puna me palë është më shumë se emocion e më shumë se përkushtim.... Ishte periudha përmblylëse e rilicencimit me pikë akredituese që e karakterizonte me numër enorm të kërkesave.

Fluksi i madh i punës përfshinte trajtimin e kërkesave për licenca dhe rilicenca, si dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me palët, të cilat shpesh përballëshin me radhë të gjata pritjeje. Situata, ndonëse sfiduese, nxori në pah solidaritetin dhe profesionalizmin e stafit, që punoi pandërprerë për t'i dhënë zgjidhje sfidave.

Para sistematizimit shihej nevoja që të formohej një databazë elektronike, ku do të bëhej regjistrimi i të gjitha licencave dhe rilicencave. Por, çdo herë në proces hasnim në gjëra të reja dhe u pa e nevojshme të identifikojë me



numrin e vendeve të antarësimit dhe më pas të vazhdohet me digjitalizimin e platformës në vitin 2019. Procedurë kjo që e ka lehtësuar si administratën, ashtu edhe antarët të cilët nga vendet e tyre ku jetojnë mund t'i kryejnë të gjitha shërbimet online. Lansimi i platformës digjitale shënoi një ndryshim të madh në marrëdhëniet me anëtarët. Përmes kësaj platforme, u krijua mundësia për të përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve dhe për të lehtësuar kontaktin me palët. Sot, anëtarët mund të kryejnë shumicën e kërkesave të tyre online, duke reduktuar kohën e pritjes dhe duke rritur efikasitetin e përgjithshëm”.



Kaltrina Sopi - Zyrtare ligjore në OIK, zyra ligjore mbështet funksionimin e përditshëm të institucionit dhe sigurimin e respektimit të rregulloreve ligjore

në të gjitha proceset. Çdo ditë pune përfshin një gamë të gjerë detyrash që variojnë nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor, ofrimi i këshillave juridike për stafin dhe anëtarët e OIK-ut, deri te përfaqësimi i institucionit në çështje ligjore apo administrative. Hartimin dhe rishikimin e kontratave dhe dokumenteve të tjera zyrtare për të garantuar që ato janë në përputhje me kornizën ligjore.



Floreta Dobra - Udhëheqëse e zyrës së financave, puna e saj siguron që stafi dhe anëtarët të ndihen gjithmonë të mirëpritur dhe të fokusuar në detyrat e tyre, pa u

shqetësuar për çështjet praktike. “Të gjitha proceset ishin shumë sfiduese por edhe na kanë mbetur kujtime të jashtëzakonshme ngase të përbashkët kishim dhe kemi dashurinë e madhe për punën dhe shembullin që donim ta arrinim. Sot, jemi shumë krenar në atë që kemi ndërtuar së bashku. Puna me numra gjithmonë kërkon vigjilencë shtesë por edhe jam e lumtur sepse fryma kolegjiale është për t'u duartrokatur dhe funksionojmë shumë mirë. E kemi mbështetur nga kryetarja por edhe vlerësimin nga ana e saj”.



Alberina Gjata - Udhëheqëse e Zyrës së Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), luan një rol të rëndësishëm në

sigurimin e cilësisë dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore në vend. Kjo zyrë siguron edukimin e vazhdueshëm profesional përmes akreditimit dhe monitorimit të programeve që ofrojnë institucionet shëndetësore publike e private, OJQ-të dhe shoqatat profesionale. Çdo program që synon akreditimin në OIK, shqyrtohet nga komisionet përkatëse, të cilët bazuar në kriteret të përcaktuara me rregullore, vendosin për miratimin e tyre. Nga funksionalizimi i zyrës për EVP në vitin 2018 deri më tani, janë akredituar mbi 700 programe nga tri nivelet e kujdesit shëndetësor, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Qëllimi kryesor i EVP-së dhe Alberinës si udhëheqëse e kësaj shtylle është zbatim i njohurive të reja në praktikën e përditshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe efikasitetin e profesionistëve shëndetësorë. Kjo iniciativë kontribuon në ruajtjen e standardeve të larta për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë, duke siguruar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional.

Zyra për Edukim të Vazhdueshëm Profesional e OIK-ut, mbetet një prej strukturave kyçe për përmbushjen e misionit të Odës në ngritjen e cilësisë së kujdesit shëndetësor në Kosovë. Përkushtimi i saj për të akredituar dhe monitoruar programe, për të lehtësuar rilicencimin dhe për të përmirësuar proceset administrative tregon qartazi përkushtimin ndaj zhvillimit profesional të anëtarëve dhe rritjes së standardeve shëndetësore në vend. Një nga sfidat më të mëdha gjatë pandemisë ishte organizimi dhe impementimi i trajnimeve për shkak të kufizimeve të pjesëmarrjes fizike, OIK iu drejtuar platformave online mbajti takime dhe trajnime të shumta në këtë formë. Ky ndryshim jo vetëm që tejkaloi vështirësitë momentale, por gjithashtu hapi rrugën për një qasje më fleksibile dhe më efektive ndaj aktiviteteve edukative.



Besian Hajrizi - Zyra për Teknologji Informativë, me marrjen e kompetencave të reja, Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK) ka shënuar një rritje të madhe në kërkesat për

digjitalizim dhe modernizim të proceseve. Për të përmbushur këto kërkesa, zyra për Teknologji Informativë (IT) është bërë një komponent kyç në zhvillimin dhe funksionimin e platformave elektronike që kanë transformuar mënyrën e ofrimit të shërbimeve për profesionistët shëndetësorë në Kosovë.

Lindja e Platformës Elektronike më 24 prill 2019, OIK lansoi platformën elektronike për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë të Kosovës, një hap madhor drejt digjitalizimit.

Falë angazhimit të zyrës për IT, platforma është përmirësuar vazhdimisht për të eliminuar pengesat teknike dhe për të siguruar një përvojë sa më të lehtë për përdoruesit. Aktualisht, mbi 90% e shërbimeve të OIK kryhen përmes platformës online, duke eliminuar nevojën për udhëtime të gjata, radhët e gjata dhe pritjet e lodhshme në zyrë. Puna online gjatë Pandemisë COVID-19, platforma e OIK u shndërrua në një mjet jetik për vazhdimin e punës pa ndërprerje. Ndërsa institucionet tjera u përballën me mbyllje dhe kufizime, OIK siguroi që shërbimet e saj të mbeten të qasshme përmes platformës elektronike. Kjo periudhë sfidash shërbeu si një test për fuqinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit, duke treguar se digjitalizimi është rruga e duhur për të ardhmen.

Me një përkushtim të vazhdueshëm për përmirësim dhe inovacion, zyra për Teknologji Informativë mbetet shtylla kryesore e zhvillimit të shërbimeve elektronike në OIK. Me plane ambicioze për zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të platformës. Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), që nga marrja e kompetencave të plota, ka shënuar një rritje të ndjeshme të kërkesave për modernizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të saj. Në këtë kontekst, zyra për Teknologji Informativë ka luajtur një rol thelbësor në lehtësimin

e procedurave administrative dhe përmirësimin e përvojës së anëtarëve të OIK.

Një nga periudhat më sfiduese për OIK ishte pandemia COVID-19. Në kohën kur shumica e institucioneve ishin të mbyllura, platforma online e OIK siguroi vazhdimësinë e punës pa ndërprerje. Gjatë kësaj periudhe, organizimi i Evenimenteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) ishte një sfidë tjetër. Kufizimet për tubime fizike u tejkaluan duke shfrytëzuar platformat online, të cilat mundësuan organizimin e takimeve dhe trajnimeve në mënyrë virtuale.



Donika Shahini Lami

- Udhëheqëse e Zyrës për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve.

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë këtë vit ka hapur zyrën për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve. Shahini Lami, është psikologe me përvojë shumëvjeçare, e cila deri më tani ka qenë pjesë e komisioneve të rëndësishme të OIK. Tani ajo është gjithashtu zëvendës kryeredaktore e revistës "Kujdesi dhe Shëndeti Infermieror".

Donika, e cila është zyrtare për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve asiston dhe do t'iu japë ndihmë psikologëve klinik, komisioneve për licencim të psikologëve klinikë si dhe bazuar në planin e punës harton raporte periodike për zyrën. Po ashtu, kjo zyrë koordinon edukimin e vazhdueshëm profesional dhe inicion tek organet e OIK gjitha propozimet në lidhje me aktet normative për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë. Zyra bashkëpunon me njësitë tjera organizative të shërbimit profesional dhe administrativ në çështjet që ndërlidhen me procedurat për licencim dhe rilicencim të psikologëve klinikë, logopedëve dhe ergoterapeutëve. Zyra mirëmban evidencë për takimet në kuadër të komisioneve dhe për mirëmbajtjen e librave të anëtarësisë.



Gëzim Rrustemi - Zyrtar


administrativ për financa, ai është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë, qoftë për çështje të vogla apo të mëdha, duke lehtësuar punën e stafit dhe duke ndikuar pozitivisht në atmosferën e përgjithshme të punës. Angazhimi i tij i pandërprerë është një frymëzim për të gjithë, duke treguar se edhe detajet më të vogla kanë një ndikim të madh në suksesin e përgjithshëm të ekipit. "Shpesh herë nuk është e lehtë por gjithmonë gjejmë zgjidhje në komunikim me antarët tonë. Ndonjëherë proceset kërkojnë kohë më të gjatë. Gjithçka është e digjitalizuar, Palëve që janë në moshë shpesh herë iu dalim në ndihmë konkrete"



Lejla Beqiri -

Përgjegjëse për rilicencim, çdo ditë kontakti me anëtarë është sfidues por dhe motivues ngase në sytë e tyre e shohim mirënjohjen dhe kjo na

mbushë me vullnet. Përkushtimi i jashtëzakonshëm dhe udhëzimet për çdo anëtar që na drejtohet pavarësisht ngarkesës, gjithashtu mbeten qëllimi jonë kryesor. Prioritet është gjithmonë mirëkuptimi dhe krijimi i një mjedisi mbështetës, ku çdo kërkesë të trajtohet me seriozitet dhe përgjegjësi. Zyrtarja për rilicencim, Lejla Beqiri, luan një rol qendror në funksionimin e përditshëm të OIK-ut, duke qenë pika e parë e kontaktit për anëtarët dhe një mbështetje thelbësore për proceset administrative. Ajo jo vetëm që trajton me profesionalizëm kërkesat për rilicencim, por gjithashtu përfaqëson fytyrën miqësore dhe të gatshme për të ndihmuar të gjithë ata që i drejtohen institucionit. Puna e saj e përkushtuar dhe qasja e kujdesshme ndaj detyrave ndihmon jo vetëm në lehtësimin e proceseve administrative, por edhe në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme dhe të besueshme midis OIK-ut dhe anëtarëve të saj.



Vlora Fejzullahu Ejupi

- Zyrtare për marrëdhënie ndërkombëtare, kjo zyrë është në njëfar mënyre urë që lidh OIK-në me

organizatat, institucionet dhe partnerët e ndryshëm ndërkombëtarë, duke krijuar mundësi për zhvillim dhe bashkëpunim. Përmes rolit të saj, ajo siguron që OIK, të jetë pjesë aktive e rrjeteve globale dhe të përfitojë nga praktikat dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. Puna me partnerë nga vende dhe kultura të ndryshme kërkon mirëkuptim dhe fleksibilitet për të tejkaluar barrierat gjuhësore dhe kulturore.

Mbajtja e ritmit me ndryshimet dhe zhvillimet ndërkombëtare kërkon hulumtim të vazhdueshëm dhe proaktivitet. Përmes marrëdhënieve ndërkombëtare, OIK-u mëson nga praktikat globale dhe ndjek standardet më të larta profesionale.

Elhame Uka - Punën në OIK e vlerëson jashtëzakonisht. "Puna në grup është e jashtëzakonshme dhe shumë motivuese. Duke pasur parasysh intensitetin e aktiviteteve në OIK, roli i saj kërkon fleksibilitet dhe energji të madhe. Çdo ditë sjell sfida të reja dhe kërkesa të shumëfishta, të cilat ajo i trajton me përkushtim dhe efikasitet. Ruajtja e standardeve të larta: Të mbash gjithçka në gjendje perfekte në një mjedis dinamik kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj detajeve.



Albina Gjoshi - Zyrtare

ligjore, e rëndësishme është që etika profesionale të jetë alfa dhe omega e punës tonë nga të dyja anët e medaljes çdo ditë.

"Duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve ligjore dhe përmirësimin e proceseve, puna ime luan një rol thelbësor në zhvillimin e OIK-ut, dhe mirëqenien e anëtarëve të saj", thekson Albina. "Puna e përditshme është e mbështetur nga një ekip i përkushtuar, duke krijuar një ambient ku bashkëpunimi dhe mbështetja janë të pranishme. Çdo rast i trajtuar është një mundësi për të fituar njohuri dhe për të thelluar kuptimin e kornizës ligjore që mbështet profesionin. Ky rol, ndonëse sfidues, është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe shpërblyes, duke ndihmuar jo vetëm në funksionimin e duhur të OIK-ut, por edhe në ngritjen e standardeve profesionale për anëtarët e saj", përfundon Albina.



Edukimi i Vazhdueshëm Profesional në gjithë regjionet e Kosovës.

Trajnime dhe ligjërata falas për të gjithë anëtarët e OIK

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK) në kuadër të sesionit vjeshtor ka realizuar projektin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) pa pagesë për të gjithë anëtarët e saj, qofshin ata të punësuar në sektorin publik, në sektorin privat apo edhe të pa punë. EVP është organizuar në të gjitha regjionet kurse anëtarët pjesëmarrës kanë përfituar pikë akredituese, të domosdoshme në procesin e rilicencimit

Prishtinë

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës (OIK) ka mbajtur sesionin vjeshtor të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në të gjitha regjionet për të gjithë anëtarët.

Kështu, në ditë të ndara, EVP është mbajtur në këto qytete të republikës së Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Podujevë dhe Vushtrri.

Tema të rëndësishme për anëtarët

Në kuadër të EVP-së janë elaboruar në të gjitha regjionet tri tema mjaft të rëndësishme që lidhen me angazhimin e profesionistëve shëndetësorë pavarësisht niveleve shëndetësore.

Legjislacioni, Etika dhe Standardet Profesionale ku potencohet rëndësia e kuadrit ligjor, çështjeve etike, dhe

mbajtjes së standardeve profesionale në praktikën e përditshme.

Ndikimi i Komunikimit dhe Bashkëpunimi, duke potencuar rëndësinë e komunikimit të qartë dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor në mes të profesionistëve për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësorë si dhe

Mbingarkesa në Punë dhe Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë që ka në fokus menaxhimin e stresit, mbrojtjen e shëndetit mendor dhe sigurinë në vendin e punës për profesionistët shëndetësorë.

Kryetarja e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës, znj. Nexhmije Gori, duke folur për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, ka thënë se është një prej komponentëve thelbësor për zhvillimin e karrierës, që synon edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

“Më shumë se një detyrë, EVP është një mundësi për të rritur njohuritë tona, për të përmirësuar aftësitë tona dhe për t’u përgatitur për sfidat e reja që na presin në fushën e shëndetësisë. Në një kohë kur kërkesat për shërbime shëndetësore po rriten, është e domosdoshme të jemi gjithmonë të përgatitur dhe të informuar për metodat dhe praktikatat më të reja shëndetësore”, ka thënë kryetarja Gori.





Andaj, EVP, sipas kryetares Gori, është një mundësi e shkëlqyeshme për të gjithë anëtarët, që të avancojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Profesor Hysni Bajrami, këshilltar ligjor i kryetares së OIK, duke vlerësuar diskutimet që janë bërë në kuadër të EVP

“E vlerësoj si imediate lidhjen e drejtpërdrejt të trupit elektoral me njësitë zgjedhore si dhe me përfaqësuesit e zgjedhur si dhe diskutimet që ndërlidhen me procedurat për iniciimin e përgjegjësive të organeve të zgjedhura”, ka thënë profesor Bajrami, duke përmendur pikat e forta të EVP-së.

ish-Kryetari i OIK, z. Naser Rrustemaj, të cilët theksuan rëndësinë e përpjekjeve për avancimin profesional të infermierëve në çdo regjion të Kosovës.

Po ashtu, në kuadër të EVP-së kanë dhënë kontribut të çmuar edhe kryetari dhe zv.Kryetari i Këshillit Drejtues z. Bashkim Mehmeti dhe z. Xhavit Ramadani, si dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional, është organizuar me pjesëmarrje fizike dhe pa pagesë për të gjithë anëtarët e OIK, derisa pjesëmarrja ka qenë pa pagesë kursë anëtarët kanë përfituar pikë akredituese, të cilat janë të domosdoshme në procesin e rilicencimit.

Foto: Nga takimi në EVP në regjione të ndryshme të Kosovës



ka thënë se në të gjitha regjionet janë ngritur çështje shumë të rëndësishme, që janë edhe prioritete të OIK-ut.



Bajrami: Vlerësoj si imediate lidhjen e drejtpërdrejt të trupit elektoral me njësitë zgjedhore

Profesor Bajrami ka folur posaçërisht për aspektet legjislative, që sipas tij, kanë një rëndësi të veçantë për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Një temë tjetër po aq e rëndësishme e ngritur nga profesor Hysni Bajrami gjatë EVP në regjionet e Kosovës është edhe çështja e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pacientit. Këto të drejta, sipas tij, janë të përcaktuara me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në sistemin shëndetësor.

Në disa nga regjionet, kanë përfaqësuar edhe zv. Kryetarët e OIK, z. Xhemajl Dugolli, si dhe znj. Leonora Bakija, si dhe





In Memoriam: Fitore Zenelaj (18.06.1990 - 13.11.2023) Infermierja, shembull i luftës kundër kancerit

Elanin, vullnetin dhe dëshirën për jetë i kishte të çelikta, sikurse që ishte edhe lufta e saj kundër kancerit të gjirit. Megjithkëtë tani një vit më pas, Fitores nuk po ia urojmë shërimin nga sëmundja e rëndë, por atë po e kujtojmë për guximin dhe forcën e shprehur gjatë betejës së saj të fundit në këtë botë.

“I dashur kancer, e jotja është të më shpallësh luftë, e imja të fitoj”

Me këto fjalë, ajo e shprehu vendosmërinë dhe guximin ndaj sëmundjes që do të përmbyllte parakohshëm misionin e saj jetësor. Shpjegimet tjera janë të panevojshme, kur bëhet fjalë për infermierën Fitore Zenelaj.

Fitorja shquhej për punën, përkushtimin e këshillat e saj e vetëm pak ditë para se të shkonte në amshim, ajo e la një mesazh, një porosi të fuqishme, pse jo ta quajmë edhe një testament për të gjitha gratë që janë prekur dhe do të diagnostifikoheshin me kancer të gjirit.

Fitorja, fitoi çdo betejë deri atë ditë, kur në luftën e ashpër fliste me të njejtën “gjuhë” që meritonte sëmundja që do ta godiste. “Jeta nuk është e lehtë për asnjë nga ne. Edhe? Ne duhet të kemi këmbëngulje dhe mbi të gjitha besim në veten tonë. Fisnike dhe e madhe. E guximshme dhe e vendosur. Besnike dhe e patrembur. Kjo është ajo që jam dhe që kam qenë gjithmonë. Dhe dijeni që mund

të ndryshojë jetën, sepse vetëdijësimi për këtë gjë, mbart një besim që nuk mund të dyfishohet në ndonjë mënyrë tjetër. Kjo jam unë!”, kështu vazhdon rrëfimin e saj, që me krenari do ta kujtojnë gjithë bashkëpunëtorët, familjarët dhe njerëzit që u sfiduan dhe morën kurajë nga Fitorja.

Ajo veshi edhe vallon e saj, para se të kalonte e qetë në botën tjetër, si një dedikim për vajzat, bashkëshortin dhe gjithë familjen që la pas. Fitorja e kishte të trasuar rrugën e fitores ndaj kancerit. Ajo s’njhihte kahje tjetër, pos fitores. Mund t’i mendonte të gjitha, përveç vdekjes. Andaj, ajo ishte zëri i të gjitha grave që sëmundja i kishte bërë të heshtnin. “Më është dashur shumë kohë për të pasur një zë që të dëgjohet dhe tani që e kam, nuk do të hesht”, ishte mesazhi që ajo e dha pasi kishte shkuar në Stamboll për të përsëritur kontrollat rutinë, pas të cilave ngriste gjithmonë një nivel më të lartë fitoreje, kundrejt sëmundjes së rëndë. “Përfundimi i kontrollës sime të fundit rezultoi me metastazë në 6-7 vende në trupit tim! Kjo është një sfidë e madhe

për mua dhe të gjithë ne dhe mendoj se të gjithë do ta kalojmë. Tani për tani nuk kemi marrë një datë përfundimi, dhe progresi po vazhdon”, ishte njoftimi që Fitore Zenelaj e dha me guxim, duke mos e ndalur luftën e saj as edhe një moment, me zërin e saj të fortë që do ta kujtojnë jo vetëm familja.

Fitorja, edhe motivin për jetë e gjente tek humanizmi, ajo gjatë kohës sa u diagnostifikua me kancerin e gjirit, gjeti forcën që të studionte pikërisht njërën nga drejtimet më humane – atë të infermierisë që e përfundoi me sukses shumë të lartë. “Mos guxoni, qoftë edhe për një sekondë, të rrethoheni me njerëz që nuk janë të vetëdijshëm për madhësinë tuaj!”, ishte porosia e saj e fuqishme. Emri i saj ishte jo vetëm simbol i fitores, por diçka shumë më e madhe. Fitorja humbi një betejë, por tek secila grua që diagnostifikohet me kohë dhe shërohet do të gjindet një dromçë e emrit të kësaj heroine.

Kujtimi për Fitoren do të jetë i përhershëm. Infermierët!



OIK do të licencojë specialistët e psikologjisë klinike dhe biokimistët me shkollim bazë në Biologji dhe Kimi

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë (OIK) ka filluar licencimin e biokimistëve me shkollim bazë të studimeve në Biologji dhe Kimi si dhe specialistëve të Psikologjisë klinike.

OIK tashmë ka marrë përmes e-mailit konfirmimet nga Ministria e Shëndetësisë për zbatim të shkresës me numër protokoll 05-7485 të Ministrit të Shëndetësisë të dates: 21 nëntor 2023.

Me këtë rast pasi ka përfunduar procesi i anëtarësimit të profesionistëve shëndetësorë si specialist të biokimisë me shkollim bazë të studimeve në Biologji dhe Kimi ata do të licencohen dhe rilicencohen nga ana e OIK-ut. Licencimi do të bëhet për biokimistët me Kodin 05-56 kurse për psikologët klinikë me kodin 05-70.

Neni 9 dhe 45 i Ligjit për Odat e Profesionistëve tjerë shëndetësorë i jep OIK-ut autorizimet ligjore

për licencimin dhe rilicencimin e biokimistëve me shkollim bazë në biologji dhe kimi si dhe specialistëve të psikologjisë klinike që aplikojnë për licencë.



OIK ka mbajtur punëtori dy-ditore për zhvillimin strategjik

Më 27-28 shtator 2024, Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK) me përkrahje nga IHS Project, organizoi punëtori dy-ditore për zhvillimin e strategjisë gjithëpërfshirëse organizative dhe avokuese.

Punëtorja ishte një hap kyç drejt forcimit të rolit të OIK në sektorin e shëndetësisë, duke u fokusuar në përmirësimin e proceseve të brendshme dhe rritjen e aftësisë për të ndikuar në politikat publike.

Për hartimin e kësaj strategjie IHS ka angazhuar ekspertë të cilët krahas me përfaqësuesit e OIK-ut, punuan në hartimin e një plani strategjik pesë-vjeçar dhe një strategjie avokuese që përputhet me politikat kombëtare të shëndetësisë.



Kryetarja, stafi dhe anëtarët e OIK-ut dhuruan gjak me rastin e Muajit Rozë

Kryetarja e Odës së Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë znj. Nexhmije Gori me bashkëpunëtorë, anëtarë të Kuvendit dhe komisioneve si dhe stafin e OIK-ut, kanë dhuruar gjak me rastin e fillimit të muajit Rozë, muaj ky i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Ky akt humanitar dhe simbolik tregon përkushtimin e palëkundur të infermierëve tanë në kujdesin dhe mbështetjen ndaj shëndetit të komunitetit.

Me dhurimin e gjakut, jo vetëm që shpëtojmë jetë, por gjithashtu përhapim mesazhin e rëndësishëm të kujdesit shëndetësor dhe ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Memorandum për fuqizimin e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë në sektorin privat



Prishtinë, 8 tetor

Oda e Infermierëve Mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK) dhe Asociacioni i Spitaleve Private të Kosovës (ASPKS) kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi.

Memorandumi është nënshkruar nga kryetarja e OIK, znj. Nexhmije Gori dhe kryetari i ASPKS, z. Armend Agani.

Ky memorandum ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi në mes të OIK-ut, dhe ASPKS për të zhvilluar një mekanizëm koordinues, në shkëmbim të informatave rreth të punësuarve, anëtarë të OIK-ut, dhe aktiviteteve profesionale që synojnë zhvillimin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë. Po ashtu, memorandum ka për qëllim përkrahjen e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor në rritjen e cilësisë së punës së tyre në institucionet private shëndetësore.

Qëllim i memorandumit mbetet gjithashtu bashkëpunimi në përmirësimin e politikave dhe procedurave për ngritjen e kapaciteteve profesionale të infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor, dhe përfaqësimi dinjitoz i interesave të tyre brenda institucioneve private shëndetësore.

Oda e Infermierëve Mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë si edhe Asociacioni i spitaleve private kanë marrë për obligim që të angazhohen në mbrojtjen dhe fuqizimin e pozicionit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor brenda sektorit privat shëndetësor, duke promovuar standarde

më të larta etike, mbështetje përmes edukimit të vazhdueshëm profesional dhe praktikës profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

ASPKS do të sigurojë mbështetje institucionale për implementimin e reformave dhe praktikave më të mira që lidhen me shërbimet e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor në institucionet private shëndetësore.



OIK merr pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Evropiane

Kryetarja e Odës së Infermierëve të Kosovës, znj. Nexhmije Gori, mori pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Evropiane të Shoqatave të Infermierëve, e mbajtur më 17 dhe 18 tetor në Varshavë, Poloni.

Gjatë këtij takimi, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me Komisionin e ri Evropian për disa çështje kyçe, përfshirë avancimin e politikave për profesionin e infermierisë, përmirësimin e kushteve të punës dhe përfshirjen e Inteligjencës Artificiale në këtë sektor.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është rritja e cilësisë së shërbimeve infermiore dhe krijimi i një

mjedisi pune më të mirë për infermierët.



OIK përfaqësohet në ceremoninë e përvjetorit të ICN

Në ceremoninë e 125 vjetorit të Këshillit Ndërkombëtar të Infermierëve (ICN) për herë të parë përfaqësuan Kosovën kryetarja e OIK, znj. Nexhmije Gori, bashkë me zv. kryetaren Leonora Bakija dhe udhëheqesën e zyrës së psikologëve znj. Donika Shahini Lami.

Në Bukuresht të Rumanisë ku është mbajtur ceremonia, u premtuan bashkëpunime frytëdhënëse ndërkombëtare nga kryetarja e ICN- znj. Pamela Cipriano.

Në këtë event prezent ishte edhe shkëlqësia e saj Princesa e Jordanit Muna al Hussein, e cila në cilësinë e ambasadorës së shëndetit dha mesazh për rëndësinë dhe angazhimin e saj për përmirësimin e shëndetit global, duke njohur kontributin e madh dhe esencial që profesionistët shëndetësorë ofrojnë në komunitete në të gjithë botën.

Kujtimet e luftës së infermierëve dukagjinas

Hidajete Krasniqi është infermiere nga Peja. Ajo tash punon në Spitalin e Pejës ku për një kohë të gjatë ka qenë drejtoreshë e infermeirisë. Ajo ishte 32 vjeçare kur u kyç në luftë, duke shërbyer si infermiere. Krasniqi sikur sot kujton sulmin në Drenicë, në familjen Jashari, që ishte edhe një nga motivet shtesë që ajo të vihej në shërbim të qytetarëve që ishin larguar nga shtëpitë e tyre por edhe ushtarëve të UÇK-së në zonën e Dukagjinit.


l" Pas sulmit në Gllogjan me 24 mars 1998, e tërë popullata që ishte në atë zonë zhvendosen në fshatrat e Lugut të Baranit. Kishte të moshuar, gra dhe fëmijë që kishin nevojë për përkujdesje dhe të gjitha që kishim punuar në sistemin paralel në Ambulancën "Medikus" si dhe atë "Nënë Tereza". Krasniqi tha se janë mobilizuar dhe punonim pa orar në ambulancën "Nënë Tereza" për të ndihmuar gjithë atë popullatë që kishin nevojë për trajtim mjekësor. Infermierët që ishin të kyçur në atë kohë në këtë ambulante ishin: Tushe Berisha, Violeta Gashi, Leonora Krasniqi, Hatixhe Krasniqi dhe unë Hidajete Krasniqi.

Gjatë sulmeve, ishte sulmuar edhe spitali ushtarak në Lrniciq dhe të plagosurit që sapo kishin dalë nga salla e operacionit i sollën në fshatin Vranoc në shtëpinë e heroit Adrian Krasniqi. Të plagosur rëndë ishin: E.H, B.H dhe shumë të tjerë. Kujdesi ndja tyre bëhej me ndërrime nga koleget e lartëcekura si dhe mjeku Dr. Ali Berisha, e që i trajtonim dhe mjekonim të gjitha këto raste. Mikpritja dhe bujaria e asaj familje nuk mungonte për asnjë moment, varësisht prej rasteve në ndihmë dhe përkujdesje vinin kohë pas kohe edhe Dr. Shpëtim Robaj tash dëshmor, si dhe kirurgu maxillofacial Dr. Shyqri Mema. Atëherë Spitali Ushtarak vendoset në Fshatin Kryshhec edhe aty nuk qëndrojmë gjatë dhe duhet të tërhiqemi nga ajo zonë. Të plagosurit barten për në Shqipëri me përcjellje të ekipeve mjekësore, gjithashtu edhe popullata

u zhvendosen duke lëvizur nga një fshat në një fshat tjetër, por asnjëherë larg atyre që kishin nevojë për trajtim mjekësor edhe pse në kushte dhe rrethana shumë të vështira. Një shtëpi në fshatin Zhabel adaptohet për Spital Ushtarak, aty takova shumë kolegë Infermierë, në fillim u takova me kolegen Shqipe Nimani nga Gergoci i komunës së Gjakovës tek Shkelzen Gashi nga Gjakova, ndërsa në ndërkohë u bashkangjitën edhe Infermierët: Milazim Delija, Selman Kelmendi, Marigona Dreshaj dhe Mimoza Ferizi e cila ishte në moshë shumë të re dhe ende nuk e kishte përfunduar shkollën e mesme të mjekësisë. Gjithashtu për të ndihmuar u bashkangjit edhe Nexhmije Gashi, jo profesioniste shëndetësore.

Ky Spital trajtoi shumë të plagosur por edhe popullatën civile që ishte fokusuar në atë zonë. Kishim ndihmë shumë të madhe nga "Mjekët pa kufi" dhe UNHCR të cilët na furnizonin me terapi dhe pako higjienike. Asnjë pacient nuk ka mbet pa terapi, kishim Sallën e operacionit të kompletuar por fatkeqësisht nuk kishim asnjë kirurg e anesteziolog. Nga ky spital ka momente të shumta të cilat vështirë mund të veçohen.

Më 31.03.1998 Spitali ishte i mbushur me të plagosur, në ndërkohë nga Lugu i Leshanit na vijnë 4 fëmijë, që gjatë granatimeve nënat e tyre kishin mbet të vdekura ndërsa njërit i kishte shpëtuar gjyshja ani pse edhe ajo e plagosur. Për atë kohë sa qëndruan



Ambulanta në Zhabel-Inf. Hidajete Krasniqi

në Spital ne ishim nëna, psikolog por edhe gjellëbërëse për ata fëmijë ngase ushqimin për të plagosur e përgatisnim vet ne. Po të njëjtën ditë nga granatimet e shumta nga Strellci sjellin shumë të plagosur dhe një nënë kishte një vajzë diku rreth shtatë vjeçare, vajza kishte barkun e shqyer dhe zorrët i kishin dalë jashtë, nga duart e nënës Dr. Alia e mori vajzën, flokët e gjata të saj preknin tokën, ne e vendosëm në sallë edhe pse e vdekur të trajtohet dinjitetshëm, mjeku përpunoi dhe qepi barkun e fëmijës, sa e vështirë ishte për neve ti mbyllim sytë një luleje që sapo kishte qelur, por mbi të gjitha më e vështira se qysh t'i komunikohet nënës sepse ajo krejt kohën kërkonte t'ia shpëtonim vajzën. Po atë ditë nga granatimet një vajzë e re që ishte në përfundim të shkollës së mesme, një pjesë e granatës i kishte goditur në pjesën e majtë të hundës dhe kishte dalur në anën e djathtë, për fat i kishte shpëtuar syri. Asaj iu bë përpunimi i plagës e ajo duke pa punën dhe angazhimin si dhe fluksin e madh të pacienteve, na ofrohet dhe thot se çka mundem të iu ndihmoj?... ngase edhe unë jam infermiere me profesion A. Sh. Në këtë spital kemi qëndruar deri me 07.04.1999, por nga ofenziva duhet tërhequr edhe pse nuk e dinim se ku do shkonim, kishim shumë të plagosur një numër prej tyre i transferuam një natë më herët në vende më të sigurta, ndërsa me



Stafi i infermierëve dhe disa ushtarë të plagosur në Zhabel



17 të plagosur dhe secili më rënd se tjetri tërhiqemi për në malin e Doboqakes ku qëndrojmë tërë ditën, infuzionet e pacienteve i kemi vendosur nëpër drunj mali, ndërsa ushqim nuk kishim, disa keksa kishim arrit t'i marrim sa për të plagosurit, ndërsa ne si staf në pusa uji pinim nga një pik uji sa me mbajt shpirtin, buzët tona nga herpesi pothuajse kishin mbyllur edhe vrimën e gojës.

Qëndruam aty deri sa ra terri edhe pse me vështirësi sepse gjithkrah ishin forcat serbe, shumë popullatë që na vinin pas na rrezikonin rrugën sepse mendonin se ne jemi shpëtimi i tyre. Kaluam shumë fshatra gjatë natës të lodhur dhe të dërmuar pothuajse tri dit e tri netë deri sa mbërrim në një fashat të quajtur Kaliqan ku ishin vendosur të plagosurit që ne i kishim nisur një natë me herët.

Aty menduam se shpëtuam dhe mund të pushojmë ndonjë ditë. Aty takuam Dr. Rifat Dreshaj i cili deri në mbarimin e luftës qëndroi me këtë ekip por edhe ku caktohej nga komanda. Luftimet dhe ofenzivat vetëm e vetëm sa shtoheshin, numri i të plagosurve po rritej, prej tyre kishim edhe pacientë ne gjendje pa vetëdije. Ne qëndruam aty deri me 13.04.1999, kur nga aty duhej transferuar në një rrugë që për neve ishte e pa njohur, po ngjiteshim majave të bjeshkëve që kurrë se kisha menduar që këmba e njeriut shkel. Ushtarët i bartnin të plagosurit ndërsa ne si personel bartnim terapinë dhe ndonjë rrobë që na kishte mbetur. Borë kishte shumë, udhëtuam gjatë gjithë ditës dhe diku ka mes i natës arritëm në bjeshkët e thata të Kaliqanit. Aty kishte shumë popullatë të vendosur, njeri prej shumë banoreve lëshoj stanin e vet për të plagosurit ndërsa ne si staf ndezëm një zjarr dhe në një trup breje mbështeteshim për pak pushim e ku ndoshta edhe nganjëherë na mashtronte gjumi.

Me 26.04.1999 me urdhër të komandës kthehemi në zonën nga kishim ardhur, të plagosurit gjatë kësaj periudhe u transferuan për në Shqipëri bashk me ta edhe një pjesë e stafit në shoqërim të tyre. Prapë tri ditë ecje vetëm natën dhe mbërritëm në zonën e luftimeve në fshatin Maznik, aty edhe ku ishte e vendosur UÇK-ja. Gjatë kësaj periudhe kishte edhe shumë ushtarë që kishin humbur jetën. Periudha e këtij Spitali ndoshta edhe pse i kishte ardhë fundi kishte luftime të mëdha, NATO-ja granatonte pozicionet serbe, forcat serbe sulmonin me gjithë artilerinë që kishin pozicionet e UÇK-së. Kishte shumë të plagosur, numri i tyre u rritej aq shumë sa që edhe shtëpitë e djegurja i improvizuam dhe i dërguam të plagosurit. Shumë raste

të prekshme sa që vështirë të ndahen, amputacione të këmbëve me brisk e briskun duke e dezinfektur në flakë, instrumentet ziheshin vetëm me ujë e për sterilizim të gazave përdornim furrën e shporetit me dru, fashat ziheshin dhe të njejtat i ternim për përdorim.



Në kohën e fundit gjatë ofensivës granata godet në ballin e një të riu E.L dhe njërin sy ia nxjerr nga vendi, kishte gjakderdhje të madhe. Për ne primare ishte të ia mbyllim plagën dhe gjakderdhjen me ia ndal, në mungesë transfuzioni ne kishim vetëm Hemacelin si infuzion. Pasi gjakderdhja u ndal dhe mjeku Dr. Alia kërkoi sterilizimin e instrumenteve dhe përgatitjen e materialit për përpunimin e plagës sepse mund të vinte deri te infeksioni. Dy orë Dr. Alia punoi ndërsa unë dhe Shqipja kemi asistuar, përpos që kujdesi ishte maksimal gjatë qepjes sepse kishim të bëjmë me dritën e syrit, mjeku u kujdes edhe t'i ruaj estetiken. Mbas dy dite kemi hap plagën dhe të plagosurit iu ka ruajt drita e syrit.

Nga gjithë këto lodhje pune dhe përkushtimi me 25.05.1999 nga ofenziva shumë e ashpër, kemi shumë të plagosur por edhe 3 të vdekur, ndër ta edhe djali i vëllaut të mjekut Dr. Ali Berisha që gjithçka dha nga vetja për shpëtimin e të plagosurve, por atij nuk arriti as ndihmën e parë të ia jep. Asnjë pikë loti, por vetëm kërkoi përkushtim maksimal nga ana e stafit për të plagosurit e tjerë me fjalën se lufta këtë e ka, duhet shpëtuar këta që kanë mbetur të gjallë. Më 26.05.1999, me urdhër të komandës duhej transferuar të plagosurit për një vend tjetër, e në përcjellje të të plagosurve nisat Infermieri Rexhep Tafa i cili mbeti i vdekur nga granatimet e forcave serbe.



Infermieri Rexhep Tafa-Dëshmor

Me 16.06.1999, kemi hyrë së bashku me UÇK-në, në qytetin tonë dhe me 18.06.1999 hyrja në spital të cilin gjatë tërheqjes së forcave e kishin demoluar në tërësi. Milazim Delija-Infermier

Me fillim të luftës u kyça në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 137 Myrtë Zeneli, duke shërbyer i palodhur anjëher ushtar i kësaj brigade. Në prill të vitit 1998, nën përcjelljen e dëshmorit Agim Zeneli dhe dëshmorit Fadil Nimanit (Tigrit) nisem për armatim për në Shqipëri, rruga ishte e gjatë dhe ecjen e bënim me kuaj por edhe armatimin e sillnim me kuaj. Gjatë rrugës mbetën disa prej ushtarëve të plagosur por edhe të vdekur, unë si profesionist me atë mundësinë që kisha dhe materialin ekzistues me iu dhënë ndihmën e parë, me rëndësi që armatimin e sillnim në Kosovë. Luftimet e ashpra dita ditës vështirësonin edhe punën tonë si profesionistë, shumë levizje nga një vend në vendin tjetër për t'i marr të plagosurit siç është Suka e Cermjanit, beteja tek vendi gjashtë shtëpitë dhe shumë vende ku kishte ofensivë e sidomos në Jablanicën e Dushkajës. Pas vendosjes së Spitalit ushtarak në Zhebel komanda më caktoi që t'i bashkohem epikës shëndetësore atje.

Rasti që më mbetet në kujtesë është pas sulmit që i bëhet Spitalit me avion ushtarak më: 31.03.1999, dhe që për të dasht sulmuar Spitalin betonimi i fortë që ishte, thyen të gjithë xhamat e dritareve të kësaj ndërtese, ndërsa nga eksplozivi që ishte menduar të bie në spital bie në oborrin e një shtëpie dhe humbi jetën nëna me dy fëmijë binjak dhe motra e tyre plagoset. Copat e viktimave mezi i bashkuam ndërsa motra që veç sa e kishin sjellë në Spital nuk ishte e njoftuar për ata çka i kisht ndodhur familjes së saj.

Më 08.05.1999 me urdhër të komandës së zonës u caktova në përcjellje të të plagosurve të Brigadës 137 Gjakova për në Shqipëri, edhe ashtu vepra. Duke e ditur se në çfarë kushte dhe rrethana i kisha lënë dy koleget e mija Hiden dhe Shqipen, edhe mungesa e terapisë ishte prezente se pse kam vepru, jam furnizu me materialin e nevojshëm dhe bashkë me shqiponjat e zeza jemi nis përgjatë kufirit. Rruga zgjati 8 ditë e 8 netë sepse shumë herë duhej të zbrapseshim ngase hasnim në forcat serbe.

Me të mbërritur në fshatin Maznik, gëzimi i madh e mposhti edhe lodhjen. Atë ditë gjeta personelin e lodhur dhe të dërmuar e që më shumë i kishte lodhur mungesa e terapisë. Me atë terapi që unë solla e përfunduam luftën dhe bashkë me të njejtin ekipë hymë në Spitalin e Pejës më: 18.06.1999, ku edhe tani punoj Infermier në repartin e Urologjisë. I lumtur dhe gjithmonë krenar që dhashë kontribut për popullin tim.

Portret: Avni Mehmeti, Kryeinfermier në Institutin Special në Shtime (ISSH)

Natyra e kujdesit ndaj shëndetit mendor kërkon nivele të larta vigjilence dhe disponueshmërie emocionale

Donika Shahini Lami

Shëndeti i pacientëve për ta është mbi të gjitha. Vështirësitë janë të mëdha. Pacientë, që për shkak të aftësive të kufizuara duhet edhe të ushqehen sikur fëmijët e vegjël. Këtë e bën rutinë secili infermier i Institutit Special në Shtime.

Për ta, janë të shumta edhe ngarkesat psikologjike për shkak të punës së rëndë në institucione të shëndetit mendor. Gjendja e rezidentëve në këto institucione është tepër e rëndë. Ndjenjat deomos janë të përziera. Gëzimi që kanë mundësi t'iu dalin në ndihmë sfidohet nga ndjesia jo e këndëshme, marrë parasysh jetën dhe vështirësitë e tyre.

Avni Mehmeti kryeinfermier në Institutin e Special në Shtime (ISSH), përtej pozitës punën e bën me shumë dashuri e përkushtim. Nga viti 2002 deri në vitin 2013 ka ushtruar detyrën e infermierit, ndërsa që nga viti 2013 vazhdon në pozitën e kryeinfermierit. Kjo përvojë e gjatë i ka mundësuar të marr njohuri dhe t'i kuptoj mirë nevojat e rezidentëve të vendosur në këtë institucion, e në veçanti mënyrën për ofrim të kujdesit që ata kërkojnë, si dhe sfidat që paraqet puna me rezidentët që trajtohen në ISSH.

Ai thekson se puna këtu është sfiduese dhe shumë e veçantë. "Të punosh këtu është tepër sfiduese, veçanërisht pasi nevojat e banorëve janë komplekse dhe të ndryshme. Shumë prej banorëve këtu kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe kujdes të veçantë, gjë që kërkon durim dhe ndjeshmëri të lartë. Puna është mendërisht dhe emocionalisht ngarkuese, por është gjithashtu e dobishme të shohësh përmirësime të vogla ose momente të bukura të cilat sjellin lumturi dhe kënaqsi tek banorët gjatë viteve të punës me ta. Ne kemi zhvilluar strategji për të përballuar këto sfida, dhe çdo ditë mundohemi të sjellim aktivitete të reja për rezidentët, duke ndryshuar rutinën vazhdimisht".

Punonjësit mund të përballen me ngarkesa të mëdha në punë, me orar të shtrirë dhe pacientë që kërkojnë kujdes të vazhduesh-

ëm. Kjo mund të shkaktojë lodhje dhe shterrim të burimeve emocionale, duke e bërë më të vështirë ruajtjen e fokusit dhe energjisë për pacientët. Puna në këtë Institut shpesh i dërgon në lodhje ekstreme për shkak të rasteve me të cilat punojnë dhe vështirësive gjatë tërë kohës së punës. Por vullneti i madh dhe njerzillëku e profesionalizmi i tyre mund çdo barrierë.

Sipas kryeinfermierit Avni Mehmeti, rastet që trajtojnë janë shpesh të rënda dhe mund të jenë rraskapitëse, si fizikisht ashtu edhe emocionalisht. "Shumë prej nesh punojmë me orë të gjata, gjë që vetëm sa shton lodhjen. Natyra e kujdesit ndaj shëndetit mendor kërkon nivele të larta vigjilence dhe disponueshmërie emocionale, gjë që mund të jetë e lodhshme, megjithatë, ne të gjithë jemi të përkushtuar ndaj roleve tona dhe bëjmë çmos për të menaxhuar lodhjen me mbështetjen e njëri-tjetrit", thotë ai.

Mbështetja e menaxhmentit ju sjellë lehtësim në punë dhe shërben edhe si vullnet për të mos u ndalur.

"Menaxhmenti ofron mbështetje të fortë, veçanërisht për t'u siguruar që ne të kemi burimet dhe trajnimin e nevojshëm për t'u kujdesur për banorët tanë. Ata janë të përgjegjshëm ndaj shqetësimeve tona dhe kontrollojnë rregullisht për të kuptuar nevojat tona. Kjo ka bërë një ndryshim të rëndësishëm, veçanërisht në mbajtjen e stafit dhe parandalimi i djegies, ata na inkurajojnë të shprehim mendimet tona se si mund të përmirësohet kujdesi, gjë që na ndihmon të ndihemi të vlerësuar". Punën e tij në Institut e quan sfidë të vërtetë por edhe dashuri të madhe.

Gatishmëria e punonjësve për të dhënë kontributin e tyre është realitet dhe vullnet i lartë tejet sakrifikes edhe përkundër se ka vështirësi reale dhe objektive gjatë ushtrimit të detyrave gjatë kohës në punë. Një pjesë e punës me pacientët me probleme mendore është të përballesh me emocione të forta dhe histori të dhimbshme. Ky aspekt mund të ndikojë negativisht në profesionistët që nuk kanë mjetet e duhura për të menaxhuar ndjenjat



e tyre. "Djegia profesionale" gjatë punës me individë që kanë probleme mendore është një fenomen që ndodh kur profesionistët e shëndetit mendor përjetojnë stres të tepruar, shterrim emocional dhe humbje të motivimit për shkak të ngarkesës së madhe emocionale dhe mendore që vjen nga puna me pacientë me çrregullime mendore. Ky fenomen është i zakonshëm në fusha si psikologjia, psikiatria, terapitë dhe asistencat sociale.

Këtë na konfirmon edhe kryeinfermieri, Avni Mehmeti, "Sfidat tona kryesore përfshijnë mungesën e stafit të mjaftueshëm infermieror dhe kërkesat e arta për kujdesin ndaj rezidentëve. Të punosh me të sëmurë me dëmtime intelektuale dhe që kanë gjendje të rëndë të shëndetit mendor do të thotë që ne shpesh përballemi me sjellje të paparashikueshme që mund të jenë të vështira për t'u menaxhuar pa personel të mjaftueshëm. Përveç kësaj, menaxhimi i stresit personal dhe shmanjia e djegies profesionale janë sfida të vazhdueshme. Megjithatë, ne gjithashtu përpiqemi t'i kapërcejmë këto sfida duke mbështetur njëri-tjetrin dhe duke avokuar për burime dhe staf më të mirë për të përmbushur nevojat e banorëve tanë". Për të parandaluar "djegien profesionale", është e rëndësishme që profesionistët të ndjekin praktika të kujdesit për veten, të kërkojnë mbështetje nga kolegët dhe të bëjnë pushime të rregullta. Po ashtu, trajnimi për menaxhimin e stresit dhe zhvillimi i aftësive për të punuar me kufinjë emocional janë strategji të dobishme. Kjo është një çështje që kërkon vëmendje dhe ndërhyrje për të mbajtur mirëqenien e punonjësve dhe efektivitetin në ofrimin e shërbimeve për ata që kanë nevojë.

Burnout në Infermieri

Autor: Sahadete Ejupi-Kallaba - MKI

Bashkautorë: Shpresa Surdulli, Sevdije Krasniqi, Shpresa Kalludra, Senay Maksut – MKI

Hyrje: Edhe pse shumë institucione janë vazhdimisht në kërkim të strategjive për të përmirësuar performancën e punonjësve, ajo çka shpesh neglizhohet është ndikimi i drejtpërdrejtë i shëndetit fizik dhe mendor në produktivitetin e tyre dhe kontributin e përgjithshëm në institucion. Prandaj, Organizata Botërore e Shëndetësisë thekson se mirëqenia mendore dhe fizike janë të pandashme, dhe të dyja janë thelbësore për aftësinë e një individi për të trajtuar stresin, për të punuar në mënyrë efikase dhe për të kontribuar pozitivisht në vendin e punës. Sipas Maslach, "Burnout-i (shqip: djegie, rraskapitje profesionale) konsiderohet si një erozion i shpirtit që vie nga një përkeqësim i vlerave, dinjitetit dhe vullnetit të dikujt. Është një sindromë që përbëhet nga kombinimi i rraskapitjes emocionale, depersonalizimit dhe ndjenjës së ulët të arritjeve personale" (Sullivan V, Hughes V, Wilson DR, 2022).

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), djegien ende nuk e konsideron si sëmundje profesionale por si sindromë

profesionale, e zakonshme që i përfshinë më shumë profesionet që kanë kontakte/marrëdhënie të shumta me individë ku hyjnë profesionistët shëndetësor dhe mësimdhënësit. Djegia te punëtorët shëndetësor ka impakt në disa aspekte, duke filluar nga cilësia e jetës së tyre, produktiviteti në punë dhe shërbimet që ofrojnë gjatë kujdesit infermior (OBSH, 2019).

Qëllimi i studimit: Duke marrë parasysh ngarkesën në punë të infermierëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor në QKUK, mjedisin e punës dhe faktorët e tjerë që lidhen me ngarkesën dhe kushtet e punës, të kuptuarit e gjendjes reale se sa e shprehur është kjo sindromë në mesin e tyre ishte motivi dhe ideja e studimit. Metodologjia: Studimi kishte qasje kuantitative. Për realizimin e hulumtimit, si instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetëtori i validuar i ndarë në tetë (8) pjesë/seksione me pyetje të mbyllura (Copenhagen Psychosocial Questionari – used in the PUMA study).

Pjesëmarrës në hulumtim ishin: infer-



mierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor (gjithsej 63 pjesëmarrës) nga klinikat e QKUK-së, të cilët ishin pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Qendra e trajnimit në QKUK. Studimi është kryer në periudhën janar-shkurt 2024. Të dhënat janë analizuar duke përdorur programin e statistikës (Excel program). Rezultatet janë prezantuar në tabela dhe grafikone. Frekuenca dhe përqindja janë përdorur për përshkrimin e rezultateve.


Rezultatet: Tabela nr 1. Përshkrimi i mostrës

Gjinia	Mosha	Niveli i Edukimit	Përvoja e punës	Vendi i Punës	Pozita në Vendin e Punës
Femra (54)	20-30 vjeq (5)		Shkolle e mesme	34	44,74%
Shkolla e Mesme (20)	1-5 vite (5)	Kirurgji (37)	Kryeinfermier/e (7)	26	34,21%
Meshkuj (9)	31-40 vjeq (25)	Niveli Bachelor (37)	6-10 vite (4)	Gjinekologji (4)	Infermierë/e (56)
	Mbi 41 vjet (33)	Niveli Master (6)	11-15 vite (11)	Interno (6)	
			16-20 vite (8)	ORL dhe Klinika e Syve (7)	
			21-30 vite (27)	Neurologji (2)	
			31+ vite (8)	Barnatore Qendrore (2)	
				Pediatri (2)	
				Stomatologji (3)	

Shumica e pjesëmarrësve në hulumtim janë të gjinisë femrore (54) ndërsa meshkuj janë vetëm 9. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin mbi moshën 41 vjeq (33). 20 infermierë kanë përfunduar

shkollën e mesme, 37 kanë përfunduar studimet në nivelin Bachelor, dhe 6 infermierë kanë kryer edhe studimet e nivelit Master. 27 infermierë kishin përvojë pune 21-30 vite. Pjesëmarrësit ishin nga


tetë Klinikat të QKUK-së dhe nga QKU e Stomatologjisë ku vetëm shtatë (7) nga ata ishin në pozitën e kryeinfermierit.



Ndikimi i punës në gjendjen emocionale

- A ju vë puna juaj në situata që ju sjellin lëkundje të emocioneve?
- A ndiheni të përfshirë emocionalisht në punën tuaj

Grafikoni nr 1. Si ndikon puna në gjendjen emocionale
Sipas rezultateve, 48 pjesëmarrës (76.1%) shpesh përjetojnë lëkundje emocionale në vendin e punës gjatë ofrimit të shërbimeve, ndërsa 34 pjesëmarrës (55.5%) shpesh nuk mund të shprehin emocionet e tyre.




Ndikimi në vendin e punës

- A keni ndikim në punën tuaj?
- A mund të ndikoni në sasinë e punës që ju është caktuar?

Grafikoni nr. 2. A ndikojnë punëtorët në vendin e punës

69.84% e pjesëmarrësve rrallë kanë ndikim në vendin e punës, derisa 84.50% rrallë kanë mundësi të ndikojnë për sasinë e punës që ju ipet.




Mbështetja kolegjiale

- Sa shpesh merrni ndihmë dhe mbështetje nga kolegët tuaj?
- Sa shpesh merrni ndihmë dhe mbështetje nga mbikqyrësi juaj?

Grafikoni nr. 3. Mbështetja kolegjiale në vendin e punës

20 pjesëmarrës (12.6%) marrin ndihmë nganjëherë nga kolegët e tyre, 19 të tjerë marrin ndihmë nganjëherë nga mbikqyrësi i tyre, ndërsa 16 të tjerë pohojnë të marrin mbështetje gjithmonë.



Në 4 javët e fundit?

- Nuk kam qenë në gjendje të përballoj marrëdhëniet me njerëzit e tjerë
- Nuk kam pasur kohë të pushoj apo të kënaqem
- Më ka munguar motivi

Grafikoni nr. 4. Vlerësimi mendor

Bazuar në rezultatet në grafikoni 4, shihet qartë ngarkesa e punës, përjetimi i stresit dhe ndikimi i tyre në shëndetin e pjesëmarrësve.

Bazuar në rezultatet në grafikoni 4, shihet qartë ngarkesa e punës, përjetimi i stresit dhe ndikimi i tyre në shëndetin e pjesëmarrësve.

Diskutimi dhe përfundimi:

Në bazë të rezultateve, shumica e infermierëve kanë një përvojë të konsiderueshme pune dhe një nivel të mirë të edukimit, por përballen me sfida të ngarkesës së lartë të punës dhe stresit. Menaxhmenti duhet të fokusohet në mbështetje emocionale dhe menaxhim më të mirë të ngarkesës për të parandaluar lodhjen mendore dhe fizike.

Rekomandimet:

- Mbështetje emocionale dhe psikologjike – Organizimi i seancave të këshillimit ose trajnimeve për mirëqenie mendore mund t'i ndihmojë infermierët të përballen me stresin e punës.
- Balancimi i ngarkesës së punës – Sigurimi i një ndarjeje të drejtë të përgjegjësisë dhe përmirësimi i kushteve të punës mund të lehtësojë lodhjen dhe stresin.

- Programet e trajnimit për menaxhimin e stresit – Trajnime për të menaxhuar stresin dhe aftësi përballuese do të ndihmonin infermierët të menaxhojnë më mirë presionin e punës.
- Rritja e pushimeve të rregullta – Lejimi i pushimeve të shkurtra gjatë ndërrimeve të gjata do të ndihmojë në rifreskimin fizik dhe mendor të infermierëve.
- Fokus te përvoja dhe edukimi – Për infermierët me më shumë përvojë ose nivele të larta edukimi, mund të ofrohen përgjegjësi shtesë që do të ishin më stimuluese dhe motivuese.

Këto masa mund të ndihmojnë në reduktimin e stresit dhe përmirësimin e mirëqenies së infermierëve.

Referencat:

1. Author(s). (2024, April). The impact of employees' health and well-being on job performance. *Journal of Education Humanities and Social Sciences*, 29, 372-378. https://www.researchgate.net/publication/380092454_The_Impact_of_Employees'_Health_and_Well-being_on_Job_Performance.
2. Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2019, 28 maj). Burn-out an occupational phenomenon: International classification of diseases. [https://www.who.int/news/item/28-05-2019-burn-out-an-occupational-phenomenon-in-](https://www.who.int/news/item/28-05-2019-burn-out-an-occupational-phenomenon-in-ternational-classification-of-diseases)

3. Montañés Muro, M. P., Ayala Calvo, J. C., & Manzano García, G. (2022, December 7). Burnout in nursing: A vision of gender and "invisible" unrecorded care. *Nursing*, First published online.
4. Nagoski, E., & Nagoski, A. (2020). *Burnout: The secret to unlocking the stress cycle*. Paperback.
5. Khatatbeh, H., Pakai, A., Al-Dwaiikat, T., Onchonga, D., Amer, F., Prémusz, V., & Oláh, A. (2022). Nurses' burnout and quality of life: A systematic review and critical analysis of measures used. *Nursing Open*, 9(3), 1564-1574. <https://doi.org/10.1002/nop2.936>
6. *Journal of Kermanshah University of Medical Sciences*. (2010). Research article. *Journal of Kermanshah University of Medical Sciences*, 14(2), e79518. Published online: September 19, 2010.
7. Sullivan V, Hughes V, Wilson DR. Nursing Burnout and Its Impact on Health. *Nurs Clin North Am*. 2022 Mar;57(1):153-169. doi: 10.1016/j.cnur.2021.11.011. Epub 2022 Feb 9. PMID: 35236605.
8. Harrad R, Sulla F. Factors associated with and impact of burnout in nursing and residential home care workers for the elderly. *Acta Biomed*. 2018 Dec 7;89(7-S):60-69. doi: 10.23750/abm.v89i7-S.7830. PMID: 30539935; PMCID: PMC6502144.
9. Suleiman-Martos N, Gomez-Urquiza JL, Aguayo-Estremera R, Cañadas-De La Fuente GA, De La Fuente-Solana EI, Al-bendín-García L. The effect of mindfulness training on burnout syndrome in nursing: A systematic review and meta-analysis. *J Adv Nurs*. 2020 May;76(5):1124-1140. doi: 10.1111/jan.14318. Epub 2020 Mar 4. PMID: 32026484.
10. Czeglédi E, Tandari-Kovács M. A kiégés előfordulása és megelőzési lehetőségei ápolók körében [Characteristics and prevention of burnout syndrome among nurses]. *Orv Hetil*. 2019 Jan;160(1):12-19. Hungarian. doi: 10.1556/650.2019.30856. PMID: 30599782.



E DREJTA E DITËVE TË LIRA NË PUNË GJATË CIKLIT MENSTRUAL

Ass. MA. Dijana Beqa - Prof. Ass. Dr. Besarta Pelaj

HYRJE

Leja menstruale është një koncept që u prezantua për herë të parë në shekullin e 19-të. Në vitin 1922, Rusia Sovjetike zbatoi një politikë të pushimit menstrual, e cila zgjati pesë vjet para se të shfuqizohej, pasi rezultoi në diskriminim ndaj fuqisë punëtore femërore.

Në vitin 1947, Japonia prezantoi pushimin menstrual, për punonjëset femra të fabrikës. Pas humbjes së Japonisë në Luftën e Dytë Botërore, u përfshi pushimi gjatë menstrua-

cioneve në ligjin e punës si një e drejtë për të gjitha gratë që punojnë.

Në Kosovë këtë të drejtë e miratoi Instituti Demokratik i Kosovës më: 08.03.2016, femrave punonjëse të këti institucioni.

Përfshirja në fuqinë punëtore ka bërë një rrugë të gjatë dhe me rritjen e përfshirjes dhe diversitetit në vendin e punës në nivel global. Ne kemi filluar të kuptojmë se dallimet biologjike, të tilla si menstruacionet, nënkuptojnë se burrat dhe gratë përballen me sfida të

ndryshme në vendin e punës. Pushimi menstrual, i cili u lejon grave të marrin pushime me pagesë ose pa pagesë nga puna për shkak të sëmundjeve dhe simptomave që lidhen me ciklin e tyre menstrual, ka qenë subjekt i polemikave të vazhdueshme. Për disa femra, periodat janë të menaxhueshme dhe mund të kenë vetëm disa ngërçe dhe simptoma në të njëjtën periudhë, ndersa për disa të tjera simptomat menstruale janë të pa përballueshme dhe kërkojnë ndihën mjekësore.

MATERIALI DHE METODOLOGJIA

Punimi konsiston në përdorim e metodës kuantitative e realizuar përmes pyetësorit i cili është shpërndarë online tek punonjëset femra të Spitalit Rajonal "Isa Grezda"

duke përfshi mjekte, infemiere, punonjëse të administratës, kuzhinierë, higjieniste etj, (femra të moshës fertile, nga 25-45 vj) si dhe asaj kualitative duke shqyrtuar hulumtime të

huaja të realizuara në vende të ndryshme me tematikë të njëjtë.

REZULATATET E HULUMTIMIT

Pjesëmarrëse në hulumtin ishin gjithësejt 57 femra, punonjëse të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, nga mosha 25-45 vjeçare.

	a.Po, më shumë se gjysmën e rasteve që kam periodat	b.Po më pak se gjysmën e rasteve që kam periodat	c. Jo
1. Keni dhimbje në pjesën e poshtme të barkut?	40.4 %	38.6 %	21.1%
2.Keni dhimbje të muskujve / kockave /nyjeve?	36.8%	36.8%	26.3%
3. Ndihehi të fryrë apo keni përjetuar ndjeshmëri të gjoksit?	50.9%	24.6%	24.6%
4.Keni dhimbje koke?	57.9%	26.3%	15.8%
5.Keni siklet për shkak të gjakderdhjes vaginale (frikë nga njollat ose aroma, siklet nga tamponi, vështirësi apo siklet gjatë aktiviteteve seksuale...)?	42.1%	14%	43.9%

Tabela 1. Përfshinë pyetjet në lidhje me përjetimin e dhimbjeve të barkut, muskujve, kockave dhe nyjeve. Pastaj ndjeshmërinë e gjoksit, dhimbjet e kokës si dhe diskomfortin e femrave si pasojë e gjakderdhjes, mbajtjes së tamponave etj.

6. Ndjehehi nervoz ose gjaknxehtë (ndjehehi nervoz, nuk jeni në gjendje të duroni ngjarje, njerëz ose situata të papritura, ndihehi lehtësisht të zemëruar)?	43.9%	26.3%	29.8%
7. Keni pagjumësi (pamundësi për të rënë ose për të qëndruar në gjumë)?	15.8%	35.1%	49.1%
8. Ndjehehi tepër të lodhur (të plogësht, me pak energji)?	43.9%	36.8%	19.3%

Tabela 2. Paraqet deklarinim e femrave rreth nervozizmit, zemërimit, problemeve me gjumin si dhe lodhjen dhe plogështinë të cilën e përjetojnë femrat gjatë periudhës së ciklit. Kjo tregon se femrat përballen me çrregullime të shumta gjatë periudhës së ciklit menstrual, të cilat padyshim ndikojnë në jetën dhe aktivitetet e përditshme.

	Aspak	Pak	Tepër shumë
9. Në ditët kur kishit , menstruacione, deri në çfarë shkalle kjo dhimbje ndërhynte në cilësinë e jetës suaj, në aktivitetet tuaja rekreative ose të punës dhe në marrëdhëniet tuaja shoqërore?	15.8%	64.9%	19.3%
10.Keni dëgjuar për 'Konceptin e pushimit menstrual'?	PO - 63.2%	JO - 36.8%	
11. A mendoni se është e nevojshme zbatimi i kësaj të drejte për femrat në raste të caktuara gjatë ciklit, edhe në Institucionin ku ju punoni?	10.5%	22.8%	66.7%

Tabela 3. Paraqet deklarin e femrave rreth ndërhyrjes së dhimbjes në cilësinë e jetës. Pastaj njohuritë rreth konceptit të "Pushimit menstrual", si dhe qëndrimet e tyre rreth zbatimit të kësaj të drejte në Institucionin ku ato punojnë.

12. A mendoni se nëse hapet një diskutim i tillë mund të cenohet privatësinë e një personi. Besohet se shëndeti menstrual duhet të jetë privat?	54.4%	31.6%	14%
13.A mendoni se hapja e kësaj teme diskutimi do t'i thyej tabutë, në shoqërinë tonë, stigmën dhe bullizmin e cila u bëhet femrave?	54.4%	31.6%	14%
14. Stigma kulturore është ende e përhapur, a mendoni se do të pengonte një zbatim efektiv?	17.5%	59.6%	22.8%
15. A mendoni se duhet të fillojë shpërndarja e pecetave higjienike falas për femra nëpër Institucionet e ndryshme, përfshirë këtu edhe shkollat	PO - 96.5%	JO - 3.5%	

Tabela 4. Paraqet qëndrimet e femrave rreth hapjes së diskutimit mbi shëndetin menstrual, thyreja e tabuve dhe stigmës, si dhe qëndrimet e tyre mbi shpërndarjen falas të pecetave higjienike, si formë mbështetjeje dhe promovimi mbi shëndetin e femrave.

Diskutim

Në përgjithësi, pushimi menstrual është një çështje e rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e grave në vendin e punës. Është e rëndësishme të konsiderohen nevojat e femrave punonjëse në lidhje me pushimin menstrual.

Nga rezultatet e anketimit vërejmë se pjesëmarrëset tona deklaruan probleme të shumta dhe të ndryshme gjatë periudhës së ciklit menstrual, si të natyrës fizike po ashtu edhe asaj psikike.

Pushimi menstrual, i njohur ndryshe si pushim periodik, është një temë diskutimi në rritje në shumë vende. Kjo politikë i lëjon femrat të marrin pushim nga puna gjatë ciklit menstrual nëse ato përjetojnë simpto-

ma të moderuara deri tek ato më të rëndat.

Në bazë të rezultateve tona të fituara në mundë të konstatojmë se një numër i konsiderueshëm i femrave të cilat punojnë në Spitalin Rajona "Isa Grezda" deklaruan simptoma të ndryshme, të cilat ndërhyjnë medoemos në mirëqenien e tyre, stabilitetin fizik dhe emocional, gjithashtu deklaruan se një pushim i tillë, në bazë të indikacioneve do të ishte më se i pranueshëm dhe i dëshirueshëm si e drejtë e tyre. Në përgjithësi, diskutimi rreth pushimit menstrual thekson rëndësinë e marrjes parasysh të nevojave të femrës, duke promovuar barazi, respekt dhe mbështetje për femrat të cilat

përjetojnë simptoma menstruale, dhe para së gjithash të tentojmë dhe ndihmojmë në uljen e stigmës dhe bullizimit që shumë femrave u bëhet në vendin e punës pikërisht për shkak të natyrës dhe gjendjes fiziologjike të një femre.

Ndërgjegjësimi dhe diskutim i hapur në vendin e punës për çështjet e pushimit menstrual, si dhe krijimi i politikave inkurajuese dhe informimi i të gjitha punonjëseve rreth tyre pastaj edukimi dhe trajnimi i punëdhësve dhe pjesës tjetër të personelit për të kuptuar dhe respektuar nevojat e punonjëseve femra në institucionin përkatës, si nevojë dhe periudhë fiziologjike e çdo femre.

Referencat:

The concept of menstrual leave, 2 May 2023, Rizichi Kashero-Ondego, CDH- KIETI LAW, LLP KENYA
Gopala B. Exploring menstrual leave as a human right: nurturing gender equality. BHAGYAMMA G, EXPLORING MENSTRUAL LEAVE AS A HUMAN RIGHT: NURTURING GENDER EQUALITY, ILE HUMAN RIGHTS LAW REVIEW. 2023 Nov 30;2(1):16-24. <https://nacionale.com/sociale/kur-do-ti-liroje-kosova-grate-e-punesuara-ne-pushim-menstrual-5650>.
Johnston-Robledo I, Chrisler JC. The menstrual

mark: Menstruation as social stigma. The Palgrave handbook of critical menstruation studies. 2020:181-99.
MENSTRUAL HEALTHQUESTIONNAIRE; IDIAP Jordi GoI, Medina-Perucha L, et al. BMJ Open 2020; 10:e035914.doi:10.1136/bmjopen-2019-035914
Proposed questions on menstrual health for inclusion in household survey questionnaires for individual women ,Zero draft (December 2022) , Prepared by the WHO/UNICEF Joint Monitoring Programme for Water Supply, Sanitation and Hygiene (JMP)

Proposed questions on menstrual health for inclusion in household survey questionnaires for individual women ; Zero draft (December 2022) , Prepared by the WHO/UNICEF Joint Monitoring Programme for Water Supply, Sanitation and Hygiene (JMP)
Dijana Atili Beqa, infermiere në hemodializë, njëkohësisht asistente e Praktikës Klinike pranë Universitetit Fehmi Agani, Fakulteti i Mjekësisë. (dijanabeqa@gmail.com)



VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE QËNDRIMEVE PËR FAKTORËT E RREZIKUT TE SËMUNDJET KRONIKE MASOVIKE JONGJITËSE

Gjyle Mexhuani – Msc, Kordinatore për EVP në QKMF në Prishtinë

Hyrje: Sëmundjet kronike masovike jongjitese kanë rol të rëndësishëm në shëndetin e popullatës, ato në më shumë se gjashtë dekada paraqesin një problem të rëndësishëm social mjekësor në tërë botën. Karakterizohen me shkallë të lartë të morbiditetit dhe mortalitetit, një veçori shumë me rëndësi e këtyre sëmundjeve është paraqitja e rasteve të reja. Këto sëmundje karakterizohen me mjekim të gjatë, mungesa të shpeshta nga puna dhe janë të përcjellura me shkallë të ndryshme të paaftësisë për punë si dhe përqindje të lartë të invaliditetit. Rehabilitimi i këtyre pacientëve është i ngadalshëm, karakterizohen me recidive të shpeshta dhe shpenzime të mëdha gjatë mjekimit, që ngarkon buxhetin familjar si dhe atë të shoqërisë në përgjithësi. Ndikim të madh kanë faktorët individual që kanë të bëjnë me stilin e jetës, mënyrën e të ushqyerit, konsumimin e duhanit dhe alkoolit, gjendjet stresuese, mos aktiviteti fizik, mbipesha etj.

Nëse flasim për ne në Kosovë atëherë dihet se këtu ende ekziston ajo që popullatën e përfaqëson një moshë relativisht e re, mirëpo edhe këtu popullata sidomos pas luftës u ballafaqua me një gjendje të rëndë të pasigurisë ekonomike, numër të madh të të papunësuarve, paga të ulëta, pasiguri fizike, dukuri evidente të një migrimi të famil-

jeve brenda vendit, neuroza e strese psikike, që kanë ndikim në prezencën e faktorëve që shkaktojnë mplakje të hershme dhe rezultojnë me paraqitjen e sëmundjes koronare të zemrës. Zhvillimi i sëmundjes të këta të sëmurë konsiston përveç tjerash edhe në atë se a mbërrijnë me kohë të mjekohen në repartet e mjekimit urgjent. Shumë analiza të bëra rreth këtij problemi tregojnë se vetëm 25% e të sëmurëve që ndodhen në institucionet shëndetësore përfundojnë me vdekje, kurse 75% të rasteve këtë e përjetojnë jashtë spitalit.

Faktorët e rrezikut për sëmundje iskemike të zemrës: Hulumtimet tregojnë se sëmundja iskemike e zemrës, si pjesë e sëmundjeve kardiovaskulare, gjithnjë e më tepër vjen si pasojë e veprimit të shumë faktorëve gjenetik dhe biologjik edhe stili i jetës shëndetshëm i jetës, veprimi i faktorëve social dhe ambienta të zhvillimi i sistemit shëndetësor. Popullata e vendeve në zhvillim, posaçërisht ajo produktive, për shkak të ndryshimit të stilit të jetës karakterizohet me rritjen e incidencës së këtyre sëmundjeve. Hulumtimet tregojnë se rritja e njohurive për stilin e jetës ndikon në zvogëlimin e kësaj sëmundje.

Metodologjia: Për studimin dhe realizimin e këtij punimi është përdorur metoda kuantitative.




Është përpiluar pyetësori i përgatitur enkas për këtë hulumtim. Pyetësori përmbante 32 pyetje me rëndësi prioritare për hulumtimin e kësaj problematike. Në anketim janë përfshirë 109 respondentë të intervistuar në mënyrë të rastit, në ambulancat specialistike (internistike-kardiologjike) të QKMF QMF dhe AMF në Prishtinë me qëllim të analizimit të njohurive dhe qëndrimeve të tyre për faktorët që mund të ndikojnë në paraqitjen e sëmundjes iskemike të zemrës.

Rezultatet: Për të pasur një pasqyrë me reale për problematikën e shqyrtuar, të dhënat e fituara dhe të përpunuara janë prezantuar në dy kapituj. Në kapitullin e parë janë paraqitur të dhënat e përgjithshme mbi të sëmurët e anketuar sipas kritereve të caktuara për hulumtim për të njohur se në ç'masë mostra është reprezentative, ndërsa në kapitullin dytë paraqiten rezultatet që kanë të bëjnë me historinë familjare të të sëmurëve dhe faktorëve të rrezikut që kanë të bëjnë me stilin e jetës.


Nr.	Grup mosha	Gjinia					
		Mashkull		Femër		Gjithsejt:	
		f	%	f	%	f	%
1.	30-39	3	5.6	1	1.8	4	3.7
2.	40-49	6	11.1	3	5.5	9	8.3
3.	50-59	10	18.5	23	41.8	33	30.3
4.	60-69	13	24.1	14	25.5	27	24.8
5.	70+	22	40.7	14	25.5	36	33
6.	Gjithsejt:	54	100	55	100	109	100

Tab.1 Numri i të anketuarve sipas grup moshës dhe gjinisë




Graf. 1 Struktura e pacientëve me histori për sëmundje të zemrës.

Historia personale e sëmundjeve të zemrës



Graf. 2 Përqindjet e përgjigjes të anketuarve lidhur me pyetjen rreth ballafaqimit me stresin ditor.

% e ballafaqimit me stresin ditor



Graf. 3 Përqindja e përgjigjes të anketuarve lidhur me pyetjen sa ditë në javë, ushtroni.

Mesatarisht sa ditë në javë ushtroni



Diskutimi: Sëmundja iskemike e zemrës është sëmundje e cila mundet që të zgjatë shumë, me të cilën individ duhet të mësohet të jetojë, prandaj edhe kërkon angazhim serioz jo vetëm nga i sëmuri e punëtorët shëndetësor por edhe nga e gjithë shoqëria në përgjithësi. Ky është edhe një prej qëllimeve të OBSH e cila tenton të angazhojë të gjithë faktorët që mund të kontribuojnë në zgjedhjen apo zvogëlimin e këtij problemi.

Grup moshat më të rrezikuara të kësaj sëmundje ishin ato prej 50-59 si dhe prej 60-69 si për rajon ashtu edhe për vetë komunën e Prishtinës. Vendet evropiane prezantuan grup moshë më të shtyra, ndërsa të dhëna të ngjashme me punimin tonë u hasën edhe në punimin për periudhën 10 vjeçare të hulumtimit në Klinikën e Sëmundjeve të brendshme në QKUK ku moshë mesatare e të sëmurëve me sëmundje iskemike të zemrës ishte 61 e më shumë vite.

Sëmundjet iskemike të zemrës paraqiten zakonisht mbi moshën 50 vjeçare, por gjatë decenieve të fundit vihet re se ato paraqiten edhe në moshë më të reja.

Shumë hulumtime kanë treguar se sëmundja iskemike e zemrës prek më shumë meshkujt se femrat. Ndonëse nuk ka ndonjë argument shkencor ekzakt në lidhje me këtë fenomen, hulumtuesit pohojnë se meshkujt janë më të rrezikuar ndaj këtyre sëmundjeve. Edhe në hulumtimin tonë gjinia me prezente ishte gjinia mashkullore.

Studimet e më hershme flasin se meshkujt sëmurën më shumë nga kjo sëmundje, por ky dallim mes gjinive zvogëlohet dhe nuk paraqet ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor.

Paraqitja e sëmundjes iskemike të zemrës te disa anëtarë të të njëjtës familje ka shtyer të dyshohet edhe në faktorin gjenetik. Në disa hulumtime të bëra kanë ardhur në përfundim se faktori gjenetik nuk është dominant për zhvillimin dhe manifestimin e sëmundjes iskemike të zemrës sepse këtë ndërlidhje me anamnezën familjare e arsyejnë me marrjen e disa vetive të prindërve si mënyra e jetës, mënyra e të ushqyerit, pirja e duhanit, mos aktiviteti fizik, situata stresuese etj. Kështu, kur faktorët e rrezikut mund të jenë nën kontroll historia familjare nuk paraqet rëndësi të theksuar.

Ngritja e vetëdijes së popullatës: Përdorimi i metodave edukativo-shëndetësore për ngritjen e vetëdijes së popullatës lidhur me veprimin e dëmshëm të faktorëve të rrezikut. Rëndësi të posaçme ka sidomos ajo që njohuritë të jepen qysh në moshat e reja.

LITERATURA

1. International medical publishers; "Clinicians of preventive services" second edition; 1996-97

2. Bekteshi T; -Faktorët e rrezikut për sëmundjet koronare që mund të eliminohen dhe të kontrollohen", 2002.

3. Elena Kocevaska -Zdravstveno vaspitanie vo prevencijata i namaluvanjetto na risk-faktorite za pojava na ishemicinte bolesti na serceto vo Republika Makedonija;Doktorska Disertacia

4. Merita Koqinaj Berisha, vlersimi klinik e socialo mjekësor të faktorëve dëmtus të sëmundja iskemike e zemrës-tezë e magistraturës-1988

5. WHO 1999 Guidelines for managment of hipertension;

6. Sheri Sheinfeld Gorin, Johan Aenold Health Promotion in Practice -2006

7. Zelmir Jaksic, Luka Kovacic i suradnici Socijalna Medicina-Zagreb 2000.

8. Sëmundjet iskemike të zemrës-Dr Hedvig Kadriu.

9. Sëmundjet interne-Grup Autorësh, Tiranë 2005.

10. Christerson B.The efect of general prectitoners advice to men with increased of ischemic heard disease.Uges laeger 1995;157(30)42448

11. Depistimi i faktorëve risk për sëmundjet kardiovaskulare në shërbimin e kujdesit parësorë Tiranë, 2006

12. Word Heart Federation, report,2006

13. Raporti i kuadrit, aktiviteteve dhe morbiditetit , 2019 IKSHPK

14. In hospital mortality following akute myocardial infarction in Kosova, Ann Saudi Med, 2009

FOTOGALERI





Oda e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

KALENDARI 2025

01 JANAR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
30	31	1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9

02 SHKURT 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	1	2
3	4	5	6	7	8	9

03 MARS 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
24	25	26	27	28	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31	1	2	3	4	5	6

04 PRILL 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
31	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11

05 MAJ 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
28	29	30	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	1
2	3	4	5	6	7	8

06 QERSHOR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
26	27	28	29	30	31	1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	1	2	3	4	5	6

07 KORRIK 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
30	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31	1	2	3
4	5	6	7	8	9	10

08 GUSHT 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
28	29	30	31	1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31
1	2	3	4	5	6	7

09 SHTATOR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12

10 TETOR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
29	30	1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9

11 NENTOR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
1	2	3	4	5	6	7

12 DHJETOR 2025

HE	MA	MER	ENJ	PR	SH	DI
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11